



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 48

Tiranë – E mërkurë, 30 mars 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 22/2022 datë 10.3.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Evropa Krijuese (2021–2027)..... 7095
Dekret i Presidentit nr. 13520, datë 28.3.2022	Për shpallje ligji..... 7102
Ligj nr. 23/2022 datë 10.3.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurime shoqërore..... 7103
Dekret i Presidentit nr. 13521, datë 28.3.2022	Për shpallje ligji..... 7111
Ligj nr. 24/2022 datë 10.3.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit..... 7112
Dekret i Presidentit nr. 13522, datë 28.3.2022	Për shpallje ligji..... 7115
Dekret i Presidentit nr. 13519, datë 25.3.2022	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 7115
Dekret i Presidentit nr. 13523, datë 28.3.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7115
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 18.3.2022	Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg..... 7116
Urdhër i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 71, datë 23.3.2022	Për delegim të përkohshëm të kompetencave..... 7119

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 17.2.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 25/22, datë 17.6.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	7120
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 4076, datë 28.3.2022	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	7136
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 181/4, datë 25.3.2022	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti arkitektonik “Mozaiku i Tiranës”.....	7136



LIGJ
Nr. 22/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT
EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
PROGRAMIN EVROPA KRIJUESE
(2021–2027)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin Evropa Krijuese (2021–2027) sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 10.3.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13520, datë 28.3.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN
PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN
“EVROPA KRIJUESE”
(2021–2027)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si “Shqipëria”), nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, Komisioni Evropian (në vijim i referuar si

“Komisioni”), në emër të Bashkimit Evropian (në vijim i referuar si “Unioni”),

në vijim të referuara si “Palët”,

DUKE PASUR PARASYSH SE një Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, nga njëra anë, dhe Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve Anëtare të tyre, nga ana tjetër, është miraturar me vendimin e Këshillit dhe Komisionit 2009/332/KE Euratom¹. Neni 129 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit parashikon se Marrëveshja Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit², e nënshkruar më 22 nëntor 2004, do të jetë pjesë përbërëse e marrëveshjes së lartpërmendur ku parashikohen parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Unionit. Kjo marrëveshje ndërkombëtare përbën dhe ka të njëjtat efekte ligjore si një memorandum mirëkuptimi i deklaruar sipas nenit 5 të Marrëveshjes Kuadër për termat dhe kushtet për pjesëmarrjen në programet e Komunitetit;

DUKE PASUR PARASYSH SE Evropa Krijuese, programi i Unionit për të mbështetur diversitetin kulturor dhe për të nxitur konkurrencën e sektorëve kulturorë dhe krijues, u krijua me rregulloren (BE) 2021/818 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit³ (në vijim e referuar si Rregullorja e Evropës Krijuese”);

DUKE PASUR PARASYSH SE në përputhje me nenin 9(2) të rregullores së Evropës Krijuese që lidhet me asociimin e vendeve të treta, termat dhe kushtet specifike të asociimit duhet të përcaktohen nga një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Unionit dhe Vendi të Asociuar;

DUKE PRANUAR se objektivat dhe parimet e përgjithshme të programit të Unionit Evropa Krijuese janë thelbësore nga pikëpamja kulturore, demokratike, mjedisore, sociale dhe ekonomike dhe janë veçanërisht të rëndësishme për shoqëritë tona dhe sektorët kulturorë që përballen me sfidat aktuale të lidhura me globalizimin, ndryshimet klimatike dhe digjitalizimin;

¹ I FZ L 107, 28.4.2009, f. 165

² 2 FZ L 192, 22.7.2005, f. 2-3

³ FZ L 189, 28.5.2021, f. 34-60



DUKE KONFIRMUAR se këta objektiva politikash, të reflektuar edhe në Konventën e UNESCO-s të vitit 2005 për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore, aplikohen nga Shqipëria duke u përballur me sfida të ngjashme dhe duke ndarë të njëjtat parime, të tilla si: demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut, duke përfshirë barazinë ndërmjet të gjithë popujve, barazinë gjinore, lirinë e shprehjes dhe lirinë artistike;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË objektivat e përbashkët, vlerat dhe lidhjet e forta të Palëve në fushën e kulturës, audio-vizuale dhe medias, të krijuara në të kaluarën nëpërmjet pjesëmarrjes në programin Evropa Krijuese 2014–2020, dhe dëshirën e përbashkët të Palëve për të zhvilluar, forcuar më tej, stimuluar dhe zgjeruar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e tyre në to;

DUKE MARRË NË KONSIDERATË kushtet e përcaktuara në nenin 9(2) të rregullores së Evropës Krijuese, vendet e Politikës Evropiane të Fqinjësisë mund të përfitojnë, gjithashtu, nga një derogim për të marrë pjesë në fushën ndërsektoriale dhe në disa veprime të fushës së medias. Kur vlerëson përshtatshmërinë e një derogimi të tillë, BE-ja merr parasysh, veçanërisht, rrethana të tilla si situata specifike e tregut audio-vizual në vendin në fjalë dhe nivelin e integritetit në politikën audio-vizuale evropiane⁴.

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

Neni 1

Fushëveprimi i asociimit

1. Shqipëria do të marrë pjesë si vend i asociuar në “Evropa Krijuese”, programi i Unionit për sektorët kulturorë dhe krijues (në vijim i referuar si “Programi”), siç përcaktohet nga rregullorja BE 2021/818 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

2. Shqipëria do të marrë pjesë si vend i asociuar në veprimet e mëposhtme të Programit:

- a) të gjitha veprimet në fushën e kulturës;
- b) të gjitha veprimet në fushën ndërsektoriale dhe në fushën e medias deri më 31 dhjetor 2022. Pas kësaj date, vazhdimi i pjesëmarrjes në fushën ndërsektoriale dhe media do të kushtëzohet nga provat e paraqitura në Union se Shqipëria plotëson

kushtet e përcaktuara në direktivën 2010/13/BE⁵, siç përmendet në nenin 9(2) të rregullores së Evropës Krijuese. Shqipëria do të garantojë që këto kushte të vijnë në përmbushjen gjatë gjithë kohëzgjatjes së Programit. Nëse provat e paraqitura nuk janë të mjaftueshme ose nëse gjatë zbatimit të Marrëveshjes rezulton se kushtet nuk janë përmbushur, pjesëmarrja në media dhe fushën ndërsektoriale do të ndërpritet ose nuk mund të zgjatet. Në rastin e parë, dispozitat e nenit 6, paragrafët 6 dhe 7 janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

Neni 2

Termet dhe kushtet e pjesëmarrjes në Programin e Evropës Krijuese

1. Shqipëria do të marrë pjesë në Program si një vend i asociuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër që mbulon pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të Unionit, dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, në aktin ligjor të referuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në çdo rregull tjetër që lidhet me zbatimin e Programit dhe aktivitetit në versionet e tyre më të përditësuara.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në termet dhe kushtet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, personat juridikë, të vendosur në Shqipëri mund të marrin pjesë në veprimet e Programit sipas kushteve të barabarta me ato të zbatueshme për personat juridikë të vendosur në Union, duke përfshirë respektimin për masat kufizuese të BE-së⁶.

3. Shqipëria do të krijojë strukturat dhe mekanizmat e duhur në nivel kombëtar dhe do të miratojë të gjitha masat e tjera të nevojshme për koordinimin dhe organizimin kombëtar të aktiviteteve për zbatimin e Programit, në përputhje me dispozitat përkatëse në rregulloren e Evropës Krijuese. Në veçanti, Shqipëria merr përsipër të krijojë një Byro për Evropën Krijuese në përputhje me nenin 7(1)(d) të rregullores për Evropën Krijuese dhe udhëzimet e dhëna nga Komisioni.

⁵ FZ L95, 15. 4. 2010, f. 1

⁶ Masat kufizuese të BE-se janë miratuar sipas nenit 29 të Traktatit për Bashkimin Evropian ose nenit 215 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

⁴ Shih pikën 34 të Rregullores për Evropën Krijuese



4. Të drejtat e Shqipërisë për përfaqësim dhe pjesëmarrje në Komitetin e Evropës Krijuese, të krijuar nga neni 24 i rregullores për Evropën Krijuese dhe nëngrupet e saj, janë ato të zbatueshme për vendet e asociuara. Si rrjedhojë, përfaqësuesit e Shqipërisë do të kenë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues në Komitetin e Evropës Krijuese përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Programit, pa të drejtë vote, për të cilin Shqipëria kontribuon financiarisht dhe për pikat që lidhen me Shqipërinë.

5. Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit të bëra nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për të marrë pjesë si vëzhgues në punën e Komitetit të referuar në nenin 24 të rregullores së Evropës Krijuese, ose në takime të tjera që lidhen me zbatimin e Programit, do të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

6. Palët do të bëjnë çdo përpjekje, brenda kuadrit të dispozitave ekzistuese, për të lehtësuar lëvizjen dhe qëndrimin e lirë të artistëve, gazetarëve dhe profesionistëve që marrin pjesë në aktivitetet e mbuluara nga kjo Marrëveshje dhe për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve të synuara për përdorim në aktivitete të tilla.

7. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme, sipas rastit, për të garantuar që mallrat dhe shërbimet e blera në Shqipëri ose të importuara në Shqipëri, të financohen pjesërisht ose tërësisht në përputhje me marrëveshjet e grantit dhe/ose kontratat e lidhura për realizimin e aktivitetëve në përputhje me këtë Marrëveshje, përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit dhe tarifën e tjera fiskale, përfshirë TVSH-në, të cilat janë të zbatueshme në Shqipëri.

8. Gjuha angleze do të përdoret nga Shqipëria për kontaktet e saj me Komisionin për procedurat që lidhen me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3

Kontributi financiar

1. Pjesëmarrja e Shqipërisë ose e personave juridikë të Shqipërisë në Program do të jetë subjekt i Shqipërisë që kontribuon financiarisht në Program dhe kostot përkatëse të menaxhimit, ekzekutimit dhe funksionimit në kuadër të buxhetit

të përgjithshëm të Unionit (në vijim i referuar si “Buxheti i Unionit”).

2. Kontributi financiar do të ketë formën e:

a) një kontributi operacional; dhe

b) një tarife pjesëmarrjeje.

3. Kontributi financiar do të jetë në formën e një pagese vjetore të bërë me një kësht, në përputhje me kërkesën për fondet, dhe do të paguhet jo më vonë se 45 ditë pas datës së thirrjes.

4. Kontributi operacional do të mbulojë shpenzimet operative dhe mbështetëse të Programit dhe do të jetë shtesë si në ndarjet e angazhimeve, ashtu edhe në pagesat ndaj shumave të regjistruara në buxhetin e Unionit, të miratuara përfundimisht për Programin.

5. Kontributi operacional bazohet në një kontribut kyç të përcaktuar si raporti i Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë me çmimet e tregut ndaj PBB-së së Unionit me çmimet e tregut. PBB-të me çmimet e tregut që do të aplikohen, do të përcaktohen nga Unioni, bazuar në të dhënat statistikore më të fundit të disponueshme për llogaritjet e buxhetit në vitin para vitit kur duhet paguar pagesa vjetore. Me anë të derogimit, për vitin 2021, kontributi operacional do të bazohet në PBB-në e vitit 2019 me çmimet e tregut. Rregullimet për këtë kontribut kyç janë përcaktuar në shtojcën I.

6. Kontributi fillestar operacional do të llogaritet duke zbatuar kontributin kyç, siç është rregulluar, për ndarjet fillestare të angazhimeve të regjistruara në buxhetin e Unionit, të miratuara përfundimisht për vitin e zbatueshëm për financimin e Programit.

7. Tarifa e pjesëmarrjes do të jetë 4% e kontributit fillestar vjetor operacional, siç llogaritet në përputhje me paragrafët 4 dhe 5 dhe do të regjistrohet në fazë, siç përcaktohet në shtojcën I.

8. Unioni do t'i ofrojë Shqipërisë informacion në lidhje me pjesëmarrjen e saj financiare, siç përfshihet në informacionin buxhetor, kontabël, të performancës dhe vlerësimin që u jepet autoriteteve buxhetore dhe zbatuese të Unionit në lidhje me programin. Ky informacion do të jepet duke pasur parasysh rregullat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave të Shqipërisë dhe Unionit dhe nuk cenon informacionin që Shqipëria ka të drejtë të marrë sipas shtojcës II.

9. Të gjitha kontributet e Shqipërisë ose pagesat nga Unioni, si dhe llogaritja e shumave të



detyrimeve ose që do të merren, do të bëhen në euro.

Neni 4

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykatës së Audituesve të Bashkimit Evropian në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti që përfshin Shqipërinë dhe Komisionin.

2. Rregullat në lidhje me menaxhimin e qëndrueshëm financiar, duke përfshirë kontrollin financiar, rikuperimin dhe masat e tjera kundër mashtrimit në lidhje me financimin e Unionit sipas kësaj Marrëveshjeje, përcaktohen në shtojcën II.

Neni 5

Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo marrëveshje do të zbatohet në përputhje me detyrimet e Palëve sipas Konventës së UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore të vitit 2005.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga data 1 janar 2021. Ajo do të mbetet në fuqi për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e të gjitha projekteve dhe aktiviteteve të financuara nga Programi, të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve.

3. Shqipëria dhe Unioni mund ta zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht në përputhje me procedurat dhe legjislacionin e tyre të brendshëm përkatës. Zbatimi i përkohshëm do të fillojë në datën kur Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

4. Nëse Shqipëria njofton Komisionin që vepron në emër të Unionit se nuk do të përfundojë procedurat e saj të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të pushojë së zbatuari në datën e marrjes së këtij njoftimi nga Komisioni, i cili do të përbëjë datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

5. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje mund të pezullohet me iniciativën e Unionit, në rast të mospagesës së kontributit financiar ose operacional që duhet paguar nga Shqipëria, siç përshkruhet në pikën II, paragrafi 3, të shtojcës I.

Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të njoftohet nga Komisioni në Shqipëri me një letër zyrtare njoftimi, e cila do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shqipëria.

Në rast se zbatimi i kësaj Marrëveshjeje pezullohet, personat juridikë të vendosur në Shqipëri, nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e dhënies së kontratës që nuk kanë përfunduar ende kur pezullimi të hyjë në fuqi. Procedura e dhënies së kontratës do të konsiderohet e përfunduar kur si rezultat i kësaj procedure janë ndërmarrë angazhime ligjore.

Pezullimi nuk cenon detyrimet ligjore të lidhura me personat juridikë të vendosur në Shqipëri përpara hyrjes në fuqi të pezullimit. Kjo Marrëveshje do të vijojë të zbatohet për këto angazhime ligjore.

Komisioni do të njoftojë menjëherë Shqipërinë pasi të jetë marrë nga Komisioni e gjithë shuma e kontributit financiar ose operacional. Pezullimi do të hiqet me efekt të menjëhershëm pas këtij njoftimi.

Që nga data e heqjes së pezullimit, personat juridikë të Shqipërisë do të jenë sërish të pranueshëm në procedurat e dhënies së kontratës të filluara pas kësaj date dhe në procedurat e dhënies së kontratës, të filluara përpara kësaj date, për të cilat nuk kanë skaduar afatet për paraqitjen e aplikimeve.

6. Secila palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë me një njoftim me shkrim që informon për qëllimin për ta përfunduar atë.

Ndërprerja do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës kur njoftimi me shkrim i arrin marrësit. Data kur përfundimi hyn në fuqi, do të



përbëjë datën e përfundimit për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

7. Kur kjo Marrëveshje pushon së zbatuari përkohësisht në përputhje me paragrafin 4 ose përfundon në përputhje me paragrafin 6, Palët bien dakord që:

a) projektet, veprimet, aktivitetet ose pjesët e tyre në lidhje me të cilat janë ndërmarrë angazhime ligjore gjatë zbatimit të përkohshëm dhe/ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe përpara se kjo Marrëveshje të pushojë së zbatuari ose të përfundojë, do të vijojnë deri në plotësimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

b) kontributi financiar vjetor i vitit N gjatë të cilit kjo Marrëveshje pushon së zbatuari përkohësisht ose përfundon, do të paguhet tërësisht në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Palët do të zgjidhin, me pëlqim të përbashkët, çdo pasojë tjetër të përfundimit ose ndërprerjes së zbatimit të përkohshëm të kësaj Marrëveshjeje.

8. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e përbashkët të Palëve. Hyrja në fuqi e amendamentit do të ndjekë të njëjtën procedurë si ajo e zbatueshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

9. Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

10. Kjo Marrëveshje do të hartohet në dy kopje në gjuhën angleze.

Bërë në, në datën..... të vitit

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:

Elva Margariti

Ministër i Kulturës

PËR BASHKIMIN EVROPIAN:

Mariya Gabriel

Komisioner për Inovacionin, Kërkimin,
Kulturën, Arsimin dhe Rininë

Shtojca I “Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë në programin e Evropës krijuese (2021–2027)”

Shtojca II “Menaxhimi financiar”

SHTOJCA I

RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E “EVROPËS KRIJUESE” (2021–2027)

1. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar i Shqipërisë në Program do të përcaktohet mbi baza vjetore në përpjesëtim me, dhe si shtesë, me shumën e disponueshme çdo vit në buxhetin e Unionit për ndarjet buxhetore të nevojshme për menaxhimin, zbatimin dhe funksionimin e Programit.

2. Tarifa e pjesëmarrjes, e përmendur në nenin 3(7) të kësaj Marrëveshjeje, do të ndahet si më poshtë:

2021: 0.5%;

2022: 1.0%;

2023: 1.5%;

2024: 2.0%;

2025: 2.5%;

2026: 3.0%;

2027: 4.0%.

3. Në përputhje me nenin 3(5) të kësaj Marrëveshjeje, kontributi fillestar operacional, që duhet paguar nga Shqipëria për pjesëmarrjen e saj në Program, do të llogaritet për vitet financiare përkatëse, duke aplikuar një rregullim në kontributin kyç.

Rregullimi i çelësit të kontributit do të jetë:

Çelësi i kontributit i rregulluar = Çelësi i kontributit x Koeficienti

Koeficienti i përdorur për llogaritjen e mësipërme për të rregulluar çelësin e kontributit do të jetë 0.55.

I. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Komisioni do t'i komunikojë Shqipërisë, sa më shpejt të jetë e mundur dhe maksimumi kur publikon thirrjen e parë për fonde të vitit financiar, informacionin e mëposhtëm:

a) shumat në ndarjet e angazhimeve në buxhetin e Unionit të miratuara përfundimisht për vitin në fjalë për linjat buxhetore që mbulojnë pjesëmarrjen e Shqipërisë në Program;

b) shumën e tarifës së pjesëmarrjes të përmendur në nenin 3(7) të kësaj Marrëveshjeje;

Në bazë të projektbuxhetit të tij, Komisioni do të sigurojë një vlerësim të informacionit për vitin



pasardhës sipas pikave “a” dhe “b” sa më shpejt të jetë e mundur, dhe maksimumi deri më 1 shtator të vitit financiar.

2. Komisioni do të lëshojë, jo më vonë se në prill të çdo viti financiar, një thirrje për fonde për Shqipërinë që korrespondon me kontributin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

Çdo thirrje për fonde do të parashikojë pagesën e kontributit të Shqipërisë jo më vonë se 45 ditë pas shpalljes së thirrjes për fonde.

Për vitin e parë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni do të lëshojë thirrjen për fonde brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

3. Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar sipas kësaj Marrëveshjeje në përputhje me paragrafin 3, të nenit 3, të kësaj Marrëveshjeje. Në mungesë të pagesës nga Shqipëria deri në datën e caktuar, Komisioni do të dërgojë një letër zyrtare kujtese.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit financiar do të shkaktojë pagesën e interesit të vonesës nga Shqipëria për shumën e papaguar nga data e caktuar.

Norma e interesit për shumat e arkëtueshme të papaguara në datën e caktuar do të jetë norma e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj të rifinancimit kryesor, siç është publikuar në serinë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie data e skadimit, e rritur me një pikë përqindje e gjysmë.

Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program mund të pezullohet nga Komisioni pas mungesës së pagesës 20 ditë pune pas një letre zyrtare, pa cenuar detyrimet e Unionit sipas marrëveshjeve të granteve dhe/ose kontratave të lidhura tashmë mbi zbatimin e veprimeve indirekte për të cilat është përzgjedhur Shqipëria.

SHTOJCA II MENAXHIMI I QËNDRUESHËM FINANCIAR

MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARE DHE RIKUPERIMI

Neni 1

Rishikime dhe auditime

1. Bashkimi Evropian ka të drejtë të kryejë, në përputhje me aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Unionit dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse, rishikime dhe auditime teknike, shkencore, financiare ose lloje të tjera në ambientet e çdo personi fizik me vendqëndrim ose çdo subjekti juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fonde nga Bashkimi Evropian, si dhe çdo palë të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Unionit me vendqëndrim ose të vendosur në Shqipëri. Rishikimi dhe auditime të tilla mund të kryhen nga agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve ose nga persona të tjerë të mandatur nga Komisioni Evropian.

2. Agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, dhe personat e tjerë të mandatur nga Komisioni Evropian, do të kenë aksesin e duhur në vendet, punët dhe dokumentet (si në versionet elektronike dhe në letër) dhe për të gjithë informacionin e kërkuar për të kryer auditime të tilla, duke përfshirë të drejtën për të marrë një kopje fizike/electronike, dhe ekstrakte, çdo dokument ose përmbajtjen e çdo mediumi të dhënash të mbajtur nga personi fizik i audituar ose personi juridik, ose nga pala e tretë e audituar.

3. Shqipëria nuk do të parandalojë ose ngrejë ndonjë pengesë të veçantë për të drejtën e hyrjes në Shqipëri dhe për hyrjen në ambientet e agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2 për arsye të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen.

4. Pavarësisht përfundimit ose ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje ose përfundimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Program, rishikimet dhe auditimet mund të kryhen edhe pasi skadimi, ndërprerja ose përfundimi përkatës hyn në fuqi, sipas kushteve të



përcaktuara në ligjin në fuqi, aktet e një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse në lidhje me çdo angazhim ligjor që zbaton buxhetin e Bashkimit Evropian të lidhur nga Bashkimi Evropian përpara datës së skadimit të kësaj Marrëveshjeje ose datës kur ndërprerja ose përfundimi përkatës i kësaj Marrëveshjeje hyn në fuqi.

Neni 2

Lufta kundër parregullsive, mashtrimeve dhe veprave të tjera penale që cenojnë interesat financiarë të Unionit

1. Komisioni Evropian dhe Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) do të autorizohen të kryejnë hetime administrative, duke përfshirë kontrolle dhe inspektime në vend, në territorin e Shqipërisë. Këto hetime do të kryhen në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara nga aktet në fuqi të një ose më shumë institucioneve të Unionit.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in brenda një kohe të arsyeshme për çdo fakt ose dyshim që u është sjellë në vëmendje në lidhje me një parregullsi, mashtrim ose aktivitet tjetër të paligjshëm që cenon interesat financiarë të Unionit.

3. Kontrollat dhe inspektimet në vend mund të kryhen në ambientet e çdo personi fizik me vendqëndrim ose person juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fonde të Bashkimit, si dhe të çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit me vendqëndrim ose të themeluar në Shqipëri.

4. Kontrollat dhe inspektimet në vend do të përgatiten dhe kryhen nga Komisioni Evropian ose OLAF në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin kompetent shqiptar të caktuar nga qeveria shqiptare. Autoriteti i caktuar duhet të njoftohet në një kohë të arsyeshme përpara për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mund të ofrojë ndihmë. Për këtë qëllim, zyrtarët e autoriteteve kompetente shqiptare mund të marrin pjesë në kontrollet dhe inspektimet në vend.

5. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me Komisionin Evropian ose OLAF-in.

6. Agjentët e Komisionit dhe stafi i OLAF-it do të kenë akses në të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, duke përfshirë të dhënat kompjuterike, mbi operacionet në fjalë, të cilat kërkojnë për kryerjen e duhur të kontrolleve dhe inspektimeve në vend. Ata, në veçanti, mund të kopjojnë dokumentet përkatëse.

7. Kur personi, subjekti ose një palë tjetër e tretë i reziston një kontrolli ose inspektimi në vend, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat dhe rregulloret kombëtare, do të ndihmojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in, për t'i lejuar të përmbushin detyrën e tyre në kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në vend. Kjo ndihmë do të përfshijë marrjen e masave të duhura paraprake sipas legjislacionit kombëtar, veçanërisht për të mbrojtur provat.

8. Komisioni Evropian ose OLAF do të informojnë autoritetet shqiptare për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve. Në veçanti, Komisioni Evropian ose OLAF do t'i raportojnë, sa më shpejt të jetë e mundur, autoritetit kompetent shqiptar çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi që u është sjellë në vëmendje gjatë kontrollit ose inspektimit në vend.

9. Pa cenuar zbatimin e së drejtës penale shqiptare, Komisioni Evropian mund të vendosë masa administrative dhe penalitete ndaj personave juridikë ose fizikë të Shqipërisë që marrin pjesë në zbatimin e një programi ose aktiviteti në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

10. Për qëllime të zbatimit të duhur të këtij neni, Komisioni Evropian ose OLAF-i dhe autoritetet kompetente shqiptare do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe me kërkesë të njëres prej palëve të kësaj Marrëveshjeje, do të konsultohen me njëri-tjetrin.

11. Për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv dhe shkëmbimin e informacionit me OLAF-in, Shqipëria do të caktojë një pikë kontakti.

12. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet Komisionit Evropian ose OLAF-it dhe autoriteteve kompetente shqiptare do të bëhet, duke pasur parasysh kërkesat e konfidencialitetit. Të dhënat personale, të përfshira në shkëmbimin e informacionit, do të mbrohen në përputhje me rregullat në fuqi.

13. Autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë me Prokurorinë Publike Evropiane për ta lejuar të përmbushë detyrën e saj për të hetuar, ndjekur



penalisht dhe sjellë para gjykimit autorët dhe bashkëpunëtorët e veprave penale që cenojnë interesat financiare të Bashkimit Evropian në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Rimëkëmbja dhe zbatimi

1. Vendimet e miratuara nga Komisioni Evropian që vendosin një detyrim monetar ndaj personave juridikë ose fizikë të ndryshëm nga shtetet në lidhje me ndonjë pretendim që rrjedh nga Programi, do të jenë të detyrueshme në Shqipëri. Urdhri i ekzekutimit i bashkëlidhet vendimit, pa asnjë formalitet tjetër përveç verifikimit të vërtetësisë së vendimit nga autoriteti kombëtar i caktuar për këtë qëllim nga Qeveria e Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë do t'i bëjë të njohur Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian autoritetin e saj kombëtar të caktuar. Në përputhje me nenin 4 të kësaj shtojce, Komisioni Evropian ka të drejtë t'u njoftojë këto vendime të detyrueshme drejtpërdrejt personave me vendqëndrim dhe personave juridikë të vendosur në Shqipëri. Zbatimi do të bëhet në përputhje me ligjin dhe rregullat e procedurës shqiptare.

2. Vendimet dhe urdhrat e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian të dhëna në zbatim të një klauzole arbitrazhi, të përfshirë në një kontratë ose marrëveshje në lidhje me programet, aktivitetet, veprimet ose projektet e Unionit, do të jenë të zbatueshme në Shqipëri në të njëjtën mënyrë si vendimet e Komisionit Evropian të përmendura në paragrafin 1.

3. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit, të përmendur në paragrafin 1 dhe për të pezulluar zbatimin e tij.

Megjithatë, gjykatat e Shqipërisë do të kenë juridiksion për ankesat se zbatimi po kryhet në mënyrë të parregullt.

Neni 4

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian të përfshira në zbatimin e Programit ose në kontrollet mbi atë program, kanë të drejtë të

komunikojnë drejtpërdrejt, duke përfshirë nëpërmjet sistemeve elektronike të shkëmbimit, me çdo person fizik me vendqëndrim ose person juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fondet e Unionit, si dhe çdo palë të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Unionit me vendqëndrim ose të vendosur në Shqipëri. Këta persona, subjekte dhe palë mund t'u paraqesin drejtpërdrejt institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian të gjithë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që u kërkohet të paraqesin në bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian të zbatueshëm për programin e Unionit dhe të kontratave ose marrëveshjeve të lidhura për zbatimin e këtij programi.

DEKRET

Nr. 13520, datë 28.3.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 22/2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Evropa Krijuese (2021–2027)”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**LIGJ**
Nr. 23/2022**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR SIGURIME SHOQËRORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:****Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, për sigurime shoqërore sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13521, datë 28.3.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE
PËR SIGURIME SHOQËRORE NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
DHE**REPUBLIKA E KOSOVËS**

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, me dëshirën për të ndërtuar marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet dy vendeve në fushën e sigurimeve shoqërore vendosën të lidhin një marrëveshje për këtë qëllim dhe ranë dakord për sa më poshtë:

PJESA I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**Neni 1**
Përkufizime

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Shqipëria”: Republika e Shqipërisë;
“Kosovë”: Republika e Kosovës.

2. “Territor”:

Për sa i përket Shqipërisë: territori i Republikës së Shqipërisë;

Për sa i përket Kosovës: territori i Republikës së Kosovës.

3. “Shtetas”:

Për sa i përket Shqipërisë: një person me shtetësi shqiptare;

Për sa i përket Kosovës: një person me shtetësi kosovare.

4. “Legjislacion”:

Ligjet dhe aktet nënligjore për sigurimet shoqërore, të caktuara sipas nenit 2, të kësaj marrëveshjeje.

5. “Autoritet kompetent”: ministrat përgjegjës për sa i përket zbatimit të legjislacionit të caktuar në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

6. “Agjenci”: institucioni, organizata ose autoriteti plotësisht ose pjesërisht përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të caktuar sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje.

7. “Agjenci kompetente”: institucioni, organizata ose autoriteti plotësisht apo pjesërisht përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të caktuar sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, i cili është kompetent për dhënien e përfitimeve.

8. “Periudha e sigurimit”: çdo periudhë e njohur si e tillë në legjislacionin e secilit shtet ku kjo periudhë është plotësuar, si dhe çdo periudhë e konsideruar si ekuivalente me një periudhë sigurimi nën atë legjislacion.

9. “Përfitimi”: çdo pension, çdo përfitim në para, të parashikuar nga legjislacioni i secilit shtet kontraktues, duke përfshirë ndonjë shtesë apo rritje, që janë të zbatueshme sipas legjislacionit të caktuar, referuar në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje.

10. “Anëtar i familjes”: çdo person i përkufizuar ose i njohur si anëtar i familjes nga legjislacioni nën të cilin janë ofruar përfitimet.



11. “Vendqëndrim” nënkupton vendin ku një person ka vendqëndrimin e zakonshëm.

12. “Qëndrim”: nënkupton vendqëndrimin e përkohshëm.

13. “Zyrë ndërlidhëse”: institucioni i caktuar nga autoriteti kompetent i secilit shtet kontraktues për të garantuar koordinimin, shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen administrative, me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshjeje në institucionet e dy shteteve kontraktuese.

2. Çdo term i papërcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, ka kuptimin që i është dhënë në legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 2

Fushëveprimi ligjor

1. Kjo marrëveshje zbatohet:

- Për sa i përket Shqipërisë, legjislacionit, për:

1) përfitimet në para për barrëldje për personat e punësuar dhe personat e vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

2) përfitimet në para për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale për personat e punësuar;

3) pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit;

- Sa i përket Kosovës, legjislacionit nga:

1) e drejta në pension kontributpagues të moshës;

2) e drejta në pension invalidor të punës;

3) e drejta në pension familjar;

4) e drejta në pension nga fondi i kursimeve pensionale individuale (shtylla e dytë).

2. Kjo marrëveshje zbatohet, gjithashtu, për të gjitha aktet apo rregulloret që amendojnë apo shtrijnë legjislacionin e specifikuar në paragrafin 1, të këtij neni.

Kjo marrëveshje zbatohet për çdo akt apo rregullore që zgjeron skemat ekzistuese për kategori të reja përfituesish, nëse, lidhur me këtë, shteti kontraktues që ka amenduar legjislacionin e vet, nuk njofton, brenda gjashtë muajve nga botimi zyrtar i ligjeve në fjalë, shtetin tjetër kontraktues për kundërshtimet e veta.

Kjo marrëveshje nuk zbatohet për aktet apo rregulloret që parashikojnë krijimin e një dege të re të sigurimeve shoqërore, nëse autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese nuk bien dakord për këtë aplikim.

Neni 3

Fushëveprimi personal

Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, kjo marrëveshje do të zbatohet tek të gjithë personat, të cilët janë ose kanë qenë subjekt i legjislacionit të njërit ose të të dyja shteteve kontraktuese, dhe të cilitdo person tjetër të drejtat e të cilit rrjedhin nga këta persona.

Neni 4

Trajtimi i barabartë

Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë marrëveshje, personat e përmendur në nenin 3 do të jenë subjekt i detyrimeve të legjislacionit të shtetit kontraktues dhe do të përfitojnë prej saj në të njëjtat kushte si shtetasit e atij shteti.

Neni 5

Eksportimi i përfitimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë marrëveshje, përfitimet sipas nenit 2 të marrëveshjes, sipas legjislacionit të njërit prej shteteve kontraktuese, nuk mund të pezullohen dhe as të jenë subjekt i ndonjë reduktimi ose modifikimi për shkak të faktit se përfituesi qëndron ose banon në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Përfitimet sipas nenit 2 të marrëveshjes, që jepen nga secili prej shteteve kontraktuese, u paguhen shtetasve të shtetit tjetër kontraktues me qëndrim në territorin e një shteti të tretë, sipas kushteve të parashikuara në legjislacionin kombëtar të shtetit të mëparshëm kontraktues për shtetasit e vet me qëndrim në territorin e atij shteti të tretë.

PJESA II

DISPOZITAT LIDHUR ME LEGJISLACIONIN E ZBATUESHËM

Neni 6

Dispozitat e përgjithshme

1. Në bazë të neneve 7 deri 10 të kësaj marrëveshjeje, legjislacioni në fuqi përcaktohet në bazë të dispozitave në vijim:

1) një person, i cili ushtron një veprimtari profesionale si i punësuar në territorin e një shteti



kontraktues do të jetë subjekt i legjislacionit të atij shteti, edhe nëse punëdhënësi apo kompania e cila punëson një person të tillë e ka vendbanimin apo selinë e tij të regjistruar në territorin e shtetit tjetër kontraktues;

2) personi, i cili është anëtar i ekuipazhit të udhëtimit, lundrimit apo të ekuipazhit të aviacionit të një kompanie, e cila operon me qira, me pagesë apo për llogari të vet, shërbimet ndërkombëtare të transportit për udhëtarë ose të mallrave me transportin hekurudhor, rrugor, ajror apo rrugë të brendshme ujore dhe kanë zyrën e vet të regjistruar në territorin e një shteti kontraktues, do të jetë subjekt i legjislacionit të atij shteti kontraktues;

3) personi, i cili ushtron një veprimtari profesionale si i punësuar në bordin e anijes që lundron me flamurin e shtetit kontraktues, do të jetë subjekt i legjislacionit të këtij shteti kontraktues.

2. Në rast se një person është njëkohësisht i punësuar në një shtet kontraktues dhe i vetëpunësuar në shtetin tjetër kontraktues, ai do të jetë subjekt i legjislacionit të shtetit ku është i punësuar.

3. Personi, i cili ushtron njëkohësisht një aktivitet pune si i vetëpunësuar në territorin e të dyja shteteve kontraktuese, do të jetë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues në territorin e të cilit ai ose ajo ka vendbanimin e tij ose të saj të rregullt. Për qëllimin e përcaktimit të shumës së të ardhurave që do të merren parasysht për kontributet sipas legjislacionit të këtij shteti kontraktues, të ardhurat profesionale, si person i vetëpunësuar, të fituara në territoret e të dyja shteteve, do të merren parasysht, në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës.

4. Personi, i cili ushtron njëkohësisht një aktivitet me pagesë në territorin e të dyja shteteve kontraktuese, do të jetë subjekt vetëm i legjislacionit të shtetit kontraktues në territorin e të cilit ai ose ajo ka vendbanimin e tij ose të saj të rregullt. Për qëllimin e përcaktimit të shumës së të ardhurave që do të merren parasysht për kontributet sipas legjislacionit të këtij shteti kontraktues, të ardhurat profesionale, si një i punësuar, të fituar në territoret e të dyja shteteve, do të merren parasysht, në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës.

Neni 7

Dispozitat e veçanta

1. Një person i punësuar, i cili duke qenë në shërbim të një punëdhënësi me një zyrë nga e cila ai varet zakonisht, në territorin e një prej shteteve kontraktuese, dërgohet nga ai punëdhënësi në territorin e shtetit tjetër kontraktues për të punuar për të, mbetet subjekt i legjislacionit të shtetit të mëparshëm kontraktues, sikur të vazhdonte të ishte i punësuar në territorin e tij, me kusht që kohëzgjatja e parashikuar e punës së tij të mos kalojë 24 muaj dhe që ai të mos jetë dërguar për të zëvendësuar një person tjetër, periodha e transferimit të të cilit ka përfunduar. Anëtarët e familjes, që shoqërojnë personin e punësuar, janë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues të mëparshëm, nëse nuk ushtrojnë aktivitete profesionale.

2. Nëse transferimi i referuar në paragrafin 1 të këtij neni vazhdon edhe pas 24 muajsh, autoritetet kompetente të të dyja shteteve kontraktuese apo agjencitë e caktuara prej tyre mund të bien dakord që punonjësi të mbetet subjekt vetëm i legjislacionit të shtetit të parë kontraktues jo më shumë se 12 muaj të tjerë.

3. Paragrafi 1, i këtij neni, zbatohet kur një person, që është dërguar nga punëdhënësi i vet nga territori i një shteti kontraktues në territorin e një vendi të tretë, dërgohet më pas nga ai punëdhënësi, nga territori i vendit të tretë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

4. Punonjësi i një shoqërie transporti, që ka zyrën e vet të regjistruar në territorin e një prej shteteve kontraktuese dhe transferohet nga punëdhënësi i vet në territorin e shtetit tjetër kontraktues apo që punon atje përkohësisht apo në mënyrë lëvizëse, është subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues në të cilin shoqëria ka zyrën e vet të regjistruar. Megjithatë, nëse shoqëria ka një degë apo përfaqësim të përhershëm në territorin e shtetit tjetër kontraktues, atëherë punonjësi i punësuar atje është subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues ku është krijuar dega apo përfaqësia e përhershme.

Anëtarët e familjes, që shoqërojnë personin e punësuar, do të jenë subjekt i legjislacionit të të njëjtit shtet kontraktues, si dhe personi i punësuar, nëse nuk ushtrojnë aktivitete profesionale.



Neni 8
Nëpunësi civil

Nëpunësi civil dhe personeli i konsideruar si ekuivalent i një shteti kontraktues, të cilët janë dërguar në territorin e shtetit tjetër kontraktues, në mënyrë që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre atje, si dhe anëtarët e familjeve të tyre, me kusht që ata të mos ushtrojnë vetë ndonjë veprimtari profesionale, do të mbeten subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues, i cili i ka dërguar.

Neni 9
**Anëtarët e misioneve diplomatike dhe
zyrave konsullore**

1. Shtetasit e një shteti kontraktues të dërguar nga qeveria e atij shteti kontraktues në territorin e shtetit tjetër kontraktues, si anëtarë të një misioni diplomatik ose një zyre konsullore, do të jenë subjekt i legjislacionit të shtetit kontraktues, i cili i ka dërguar.

2. Personat lokalë, të punësuar nga një mision diplomatik ose konsullor të një prej shteteve kontraktuese në territorin e shtetit tjetër kontraktues, do t'u nënshtrohen legjislacionit të shtetit kontraktues ku ndodhet misioni diplomatik ose zyra konsullore. Ata mund të zgjedhin zbatimin e legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues brenda tre muajve pas fillimit të veprimtarisë së tyre ose pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

3. Kur misioni diplomatik apo zyra konsullore e shtetit akreditues punëson persona që, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, janë subjekt i legjislacionit të shtetit pritës, misioni apo zyra do të përmbushë detyrimet e vendosura për punëdhënësit në bazë të legjislacionit të shtetit kontraktues ku ndodhet misioni diplomatik ose zyra konsullore.

4. Dispozitat e përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3, të këtij neni, do të zbatohen, gjithashtu, për analogji të personave të punësuar në shërbimin privat të një personi të caktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Dispozitat e këtij neni, gjithashtu, zbatohen tek anëtarët e familjes së personave të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, vetëm nëse ata ushtrojnë vetë ndonjë veprimtari profesionale.

Neni 10
Përfjashtimet

Autoritetet kompetente, sipas një marrëveshjeje të përbashkët, në interes të personave të caktuar të siguruar ose të kategorive të caktuara të personave të siguruar, mund të parashikojnë përjashtime nga dispozitat e neneve 6 deri në 9 të kësaj marrëveshjeje, me kusht që personat në fjalë, do të jenë subjekt i legjislacionit të një prej shteteve kontraktuese.

PJESA III
**DISPOZITAT E VEÇANTA LIDHUR ME
PËRFITIMET**

KAPITULLI 1
**BARRËLINDJA, AKSIDENTET NË PUNË
DHE SËMUNDJET PROFESIONALE**

Neni 11

Përfitimet në para për barrëljindjen vetëm për Shqipërinë:

Përfitimet në para jepen nga institucioni kompetent shqiptar vetëm sipas dispozitave ligjore të zbatueshme të legjislacionit shqiptar. Për plotësimin e kushteve ligjore, kur është e nevojshme merren në konsideratë edhe periudhat e sigurimit, të realizuara në Republikën e Kosovës.

Neni 12

**Marrja parasysh e aksidenteve në punë, si
dhe sëmundjeve profesionale, të cilat kanë
ndodhur në të kaluarën**

Nëse legjislacioni i një shteti kontraktues siguron se aksidentet në punë apo sëmundjet profesionale, të cilat kanë ndodhur më parë, do të merren parasysh për të vlerësuar shkallën e paaftësisë për punë, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, të cilat kanë ndodhur më parë nën legjislacionin e shtetit tjetër kontraktues, do të konsiderohen se kanë ndodhur sipas legjislacionit të shtetit të mëparshëm.



Neni 13

Konstatimi i një sëmundjeje profesionale

1. Kur një person ka një sëmundje profesionale, sipas legjislacionit të të dyja shteteve kontraktuese, ka ushtruar një aktivitet i cili ka të ngjarë ta ketë shkaktuar atë sëmundje, përfitimet që personi apo të mbijetuarit e sëmundjes profesionale, të cilët mund kërkojnë, duhet të jepet vetëm në përputhje me legjislacionin e shtetit kontraktues në territorin e të cilit ky aktivitet është ndjekur së fundi, duke marrë parasysh faktin nëse personi në fjalë i plotëson kushtet e këtij legjislacioni, konsideruar sipas rastit edhe dispozitat e paragrafit 2, të këtij neni.

2. Nëse sipas legjislacionit të një shteti kontraktues, dhënia e përfitimeve në lidhje me një sëmundje profesionale i nënshtrohet kushtit që sëmundja në fjalë është diagnostikuar për herë të parë në territorin e tij, ky kusht do të konsiderohet i plotësuar edhe nëse sëmundja në fjalë është diagnostikuar për herë të parë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

3. Në qoftë se, sipas legjislacionit të një shteti kontraktues, dhënia e përfitimeve në lidhje me një sëmundje profesionale i nënshtrohet kushtit që aktiviteti i ushtruar gjatë një periudhe të caktuar ka shkaktuar sëmundjen në fjalë, agjencia kompetente e këtij shteti do të marrë parasysh, nëse është e nevojshme, periudhat gjatë të cilave ky aktivitet është ushtruar sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, sikur ai aktivitet të kishte qenë ushtruar sipas legjislacionit të shtetit të parë.

Neni 14

Përkeqësimi i një sëmundjeje profesionale

Në rast të përkeqësimit të një sëmundjeje profesionale, nëse personi që ka marrë ose merr kompensim për një sëmundje profesionale sipas legjislacionit të njërit prej shteteve kontraktuese, për një sëmundje profesionale të së njëjtës natyrë, kërkon të drejtat për përfitime sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, do të zbatohen rregullat e mëposhtme:

1. Nëse një person nuk ka ushtruar në territorin e shtetit të fundit një aktivitet profesional, i cili mund të shkaktojë ose të përkeqësojë sëmundjen profesionale në fjalë, agjencia kompetente e shtetit të mëparshëm do të jetë e detyruar për të

përmbushur shpenzimet e përfitimit sipas legjislacionit që administron, duke marrë parasysh çdo përkeqësim;

2. Nëse një person ka ushtruar një aktivitet të tillë profesional në territorin e shtetit të fundit, agjencia kompetente e shtetit të mëparshëm do të jetë e detyruar të përmbushë shpenzimet e përfitimeve, sipas legjislacionit që administron, pa marrë parasysh përkeqësimin e sëmundjes. Agjencia kompetente e shtetit të dytë, i jep një ndihmë financiare personit në fjalë, shuma e së cilës përcaktohet nga legjislacioni i këtij shteti dhe do të jetë e barabartë me diferencën midis shumës së përfitimit pas përkeqësimit të sëmundjes dhe shumës përkatëse të përfitimit para përkeqësimit të sëmundjes profesionale.

KAPITULLI 2

**PENSIONI I PLEQËRISË,
INVALIDITETIT DHE FAMILJAR**

PJESA 1

**DISPOZITAT E VEÇANTA LIDHUR ME
PËRFITIMET NË SHQIPËRI**

Neni 15

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, për përfitim pleqërie, familjar apo invaliditeti, periudhat e sigurimit dhe periudhat ekuivalente, të plotësuara sipas legjislacionit të Kosovës, do të bashkohen kur është e nevojshme me periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të Shqipërisë, me kusht që ato të mos mbivendosen.

Kur periudhat e sigurimit, të realizuara në të dyja shtetet, mbivendosen, Shqipëria do të marrë parasysh vetëm periudhat e sigurimit të realizuara në territorin e saj.

2. Nëse legjislacioni shqiptar e lidh dhënien e përfitimit të pleqërisë, familjar ose invaliditetit, me kushtin që periudhat e sigurimit të plotësohen në një profesion të caktuar, do të bashkohen për dhënien e së drejtës të këtyre përfitimeve vetëm periudhat e sigurimit të plotësuara apo të njohura si ekuivalente në të njëjtin profesion në Kosovë.

3. Nëse, pavarësisht zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, një person nuk përmbush kriteret për të marrë një përfitim, do të bashkohen periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit të një



shteti të tretë me të cilin njëri nga shtetet kontraktuese ka marrëveshje për sigurimet shoqërore, që mundësojnë bashkimin e periudhave të sigurimit.

Neni 16

Llogaritja e përfitimeve të pleqërisë, invaliditetit dhe pensionit familjar

Nëse sipas legjislacionit shqiptar, e drejta për përfitim lind vetëm përmes bashkimit të periudhave të sigurimit sipas nenit 15 të kësaj marrëveshjeje, atëherë ky përfitim llogaritet duke marrë për bazë periudhat e sigurimit, të realizuara sipas këtij legjislacioni.

Neni 17

Rishikimet e mundshme të përfitimeve

Nëse, për shkak të rritjes së kostos së jetesës, lëvizjes së niveleve të pagave apo kushteve të tjera të përshtatjes, përfitimet e pleqërisë, familjare ose invaliditetit të njërit prej shteteve kontraktuese, ndryshojnë me një përqindje apo shumë të caktuar, nuk është e nevojshme të procedohet me një llogaritje të re të përfitimeve të pleqërisë, familjare apo invaliditetit të shtetit tjetër kontraktues.

PJESA 2

DISPOZITAT E VEÇANTA LIDHUR ME PËRFITIMET NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 18

Bashkimi i periudhave të sigurimit

1. Nëse personi nuk ka të drejtë në një pension kontributpagues të moshës dhe pension familjar, në bazë të periudhave të sigurimit sipas ligjeve kosovare, e drejta në përfitimet në fjalë përcaktohet me grumbullimin e këtyre periudhave të realizuara konform legjislacionit shqiptar, me kusht që ato të mos mbivendosen.

2. Nëse legjislacioni kosovar lidh dhënien e përfitimit të pensionit kontributpagues të moshës dhe pensionit familjar, me kushtin që periudhat e sigurimit të plotësohen në një profesion të caktuar, do të bashkohen për dhënien e së drejtës të këtyre përfitimeve vetëm periudhat e sigurimit të

plotësuar apo të njohura si ekuivalente në të njëjtën profesion në Shqipëri.

3. Nëse, pavarësisht zbatimit të paragrafit 1, të këtij neni, një person nuk përmbush kriteret për të marrë një përfitim, do të bashkohen periudhat e sigurimit, të plotësuar sipas legjislacionit të një shteti të tretë me të cilin njëri nga shtetet kontraktuese ka marrëveshje për sigurimet shoqërore, që mundësojnë bashkimin e periudhave të sigurimit.

Neni 19

Llogaritja e pensioneve kontributpaguese të moshës, pensioneve familjare pa bashkim të periudhave të sigurimit

Nëse personi i plotëson kushtet për realizimin e së drejtës në përfitime sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, agjencia kompetente e Kosovës, i bën llogaritjet vetëm në bazë të periudhave të sigurimit, të realizuara konform legjislacionit të Kosovës.

Neni 20

Llogaritja e pensioneve kontributpaguese të moshës dhe pensioneve familjare me bashkim të periudhave të sigurimit

Nëse e drejta për përfitim lind vetëm përmes bashkimit të periudhave të sigurimit, sipas nenit 18 të kësaj marrëveshjeje, atëherë ky përfitim llogaritet duke marrë për bazë periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit të Kosovës.

PJESA 3

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA TË PËRFITIMEVE

Neni 21

Periudhat e sigurimit më pak se 12 muaj

Nëse periudha e sigurimit total për llogaritjen e përfitimit në përputhje me legjislacionin e një shteti kontraktues, nuk i kalon 12 muaj, përfitimi nuk do të jepet, me përjashtim të rasteve, kur në përputhje me legjislacionin, ekziston një e drejtë për përfitim e bazuar ekskluzivisht në këtë periudhë sigurimi.



PJESA IV
DISPOZITAT E NDRYSHME

Neni 22

Përgjegjësitë e autoriteteve kompetente

Autoritetet kompetente:

1. do të përcaktojnë me anë të një marrëveshjeje administrative, masat e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe caktojnë zyrat ndërlidhëse, si dhe agjencitë kompetente;

2. do të përcaktojnë procedurat për ndihmën e ndërsjellë administrative dhe mënyrat e pagesës së shpenzimeve të nevojshme për lidhjen e kësaj marrëveshjeje;

3. do të komunikojnë drejtpërdrejt në mënyrë reciproke çdo informacion tjetër lidhur me masat e marra për zbatimin e kësaj marrëveshjeje;

4. do të komunikojnë drejtpërdrejt, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha ndryshimet në legjislacionin e tyre në masën që këto ndryshime të ndikojnë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 23

Bashkëpunimi administrativ

1. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente, agjencitë ndërlidhëse, si dhe agjencitë kompetente të të dyja shteteve kontraktuese, do t'i japin njëri-tjetrit një ndihmë reciproke, sikurse do të vepronin për zbatimin e legjislacionit të tyre. Kjo ndihmë është falas për aq kohë sa autoritetet kompetente nuk kanë rënë dakord ndryshe. Megjithatë, autoritetet kompetente mund të bien dakord për rimbursimin e disa shpenzimeve.

2. Nëse legjislacioni i njërit shtet kontraktues parashikon përjashtimin ose zbritjen nga tatimet, vulat apostile ose tarifa për kërkesa apo dokumente, të cilat sipas këtij legjislacioni duhet paraqitur, atëherë ky përjashtim ose zbritje vlen edhe për kërkesa dhe dokumente, të cilat paraqiten ose kërkohen nga autoriteti ose agjencia kompetente e shtetit tjetër kontraktues për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

3. Të gjitha aktet dhe dokumentet, të lëshuara në zbatim të kësaj marrëveshjeje, përjashtohen nga legalizimi nga ana e autoriteteve diplomatike dhe konsullore.

4. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente, zyrat ndërlidhëse, si dhe agjencitë

kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin, si dhe me çdo person, pavarësisht nga vendbanimi i atij personi. Korrespondenca mund të kryhet në njërën nga gjuhët zyrtare të shteteve kontraktuese.

5. Ekzaminimet mjekësore të personave që banojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues, kryhen nga institucioni i vendit të banimit me kërkesë dhe shpenzimet e agjencisë kompetente të shtetit kërkuar. Kostot e ekzaminimeve mjekësore nuk kompensohen nëse ekzaminimet kryhen në interesin e institucioneve të të dyja shteteve kontraktuese.

Neni 24

Shkëmbimi dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshjeje, agjencitë e të dyja shteteve kontraktuese, shkëmbejnë të dhënat personale, duke përfshirë edhe të dhënat në lidhje me të ardhurat financiare të personave që agjencisë së shtetit kontraktues i nevojiten për zbatimin e legjislacionit të sigurimeve shoqërore.

2. Në komunikimin e këtyre të dhënave personale, agjencia e një shteti kontraktues duhet të respektojë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve të tij.

3. Mbatja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave personale nga agjencia e shtetit kontraktues, në të cilin këto të dhëna janë komunikuar, i nënshtrohen legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale të këtij shteti kontraktues.

4. Të dhënat e përmendura në këtë nen, përdoren vetëm për zbatimin e legjislacionit në lidhje me sigurimin shoqëror.

Neni 25

Kërkesat, apelimet dhe afatet

1. Kërkesat, deklaratimet dhe apelimet, të cilat për zbatimin e legjislacionit të njërit shtet kontraktues duhen dorëzuar brenda një afati të caktuar pranë agjencisë kompetente të këtij shteti kontraktues, vlejnë si të dorëzuara brenda afatit, edhe kur dorëzohen pranë agjencisë kompetente të shtetit tjetër kontraktues brenda të të njëjtat afat.



2. Agjencia kompetente, e cila pranon kërkesa, deklarime apo apelime, ia transmeton ato menjëherë agjencisë kompetente të shtetit tjetër kontraktues, duke përmendur datën e marrjes së dokumentit të shkruar.

3. Kërkesa e paraqitur për përfitimin në agjencinë kompetente të një shteti kontraktues, konsiderohet njëjtë si të jetë dorëzuar në agjencinë kompetente të shtetit tjetër kontraktues për përfitimet përkatëse.

4. Një kërkesë ose dokument nuk duhet të refuzohet me arsyetimin se ajo është shkruar në një gjuhë zyrtare të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 26

Pagesa e përfitimeve

1. Përfitimet në para, që rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje, mund të paguhet në valutën e shtetit kontraktues ose në një valutë tjetër të përcaktuar nga ky shtet kontraktues. Kursi i këmbimit valutor do të jetë kursi zyrtar i datës së kryerjes së pagesës.

2. Legjislacioni i një shteti kontraktues nuk mund të ndërhyjë në kontrollet e valutës me transferimin e lirë të fondeve që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Neni 27

Njohja e vendimeve dhe dokumenteve ekzekutive

Vendimet e agjencive kompetente të njërit shtet kontraktues u dërgohen personave të cilët kanë vendqëndrim në shtetin tjetër kontraktues. Një kopje e vendimit i dërgohet zyrës ndërlidhëse të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 28

Pagesat e tepërta

Kur agjencia e një shteti kontraktues e ka paguar përfituesin me një shumë që e tejkalon atë që i takon, atëherë kjo tepëri monetare mund të zbritet nga një përfitim i ngjashëm që paguhet sipas legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues dhe i kreditohet institucionit të shtetit të parë kontraktues.

Neni 29

Bashkëpunimi në luftën kundër mashtrimit

Përveç zbatimit të parimeve të përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin administrativ, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, do të bien dakord në marrëveshjen administrative për termat dhe kushtet specifike, sipas të cilave ata do të bashkëpunojnë, për të luftuar mashtrimin në lidhje me përfitimet.

Neni 30

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet, që lindin gjatë zbatimit apo interpretimit të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen me negociata në mes të autoriteteve kompetente.

PJESA V

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 31

Rastet para hyrjes në fuqi të marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje nuk përbën bazë për pretendime lidhur me pagesat për kohën para hyrjes së saj në fuqi.

2. Periudhat e sigurimit, të përmbushura para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, sipas dispozitave ligjore të shteteve kontraktuese dhe rrethanat e tjera me rëndësi ligjore, do të merren parasysh gjatë zbatimit të saj.

3. Vendimet, të cilat janë marrë para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, nuk janë në kundërshtim me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

4. Kjo marrëveshje nuk do të zbatohet tek të drejtat që janë likuiduar nga dhënia e një shume të njëhershme të pagesës ose nga rimbursimi i kontributeve.

Neni 32

Rishikimi, parashkrimi dhe humbja e së drejtës

1. Çdo përfitim, që nuk i është paguar apo që është pezulluar për arsye të shtetësisë së personit në fjalë apo për arsye të vendqëndrimit të tij në territorin e një shteti kontraktues, përveç atij në



cilin ndodhet agjencia kompetente për pagesë, me kërkesën e personit të interesuar do të paguhet apo rivendoset që nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje.

2. E drejta e personave të interesuar, të cilët para hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje kanë marrë pagesën e një përfitimi, mund të rishikohet gjatë aplikimit nga ata persona, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Në asnjë rast ky rishikim nuk do të çojë në zbritjen e së drejtës së parë të personit në fjalë.

3. Nëse kërkesa e referuar në paragrafët 1 ose 2 të këtij neni bëhet brenda dy vjetëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, çdo e drejtë që rrjedh nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të jetë efektive nga data e hyrjes në fuqi dhe legjislacioni i secilit shtet kontraktues në lidhje me humbjen apo parashkrimin e të drejtave nuk do të jetë i zbatueshëm për personin në fjalë.

4. Nëse kërkesa e referuar në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni bëhet pas dy vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, të drejtat, që nuk janë subjekt i humbjes apo që nuk janë parashkruar, do të merren nga data e kërkesës, në rast se nuk do të ketë dispozita legjislative më të favorshme të shtetit kontraktues në fjalë.

Neni 33

Kohëzgjatja, ndryshimi dhe anulimi i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo zgjerohet me kërkesë të shkruar të njërit shtet kontraktues në mirëkuptim të dyanshëm të të dyja shteteve kontraktuese.

3. Çdo shtet kontraktues, mundet, përmes rrugëve diplomatike, në formë të shkruar, të shfuqizojë këtë marrëveshje, duke respektuar afatin dymbëdhjetë muaj para përfundimit të vitit kalendarik.

4. Nëse marrëveshja shfuqizohet, atëherë dispozitat e saj për të drejtat e fituara deri në atë moment vazhdojnë të jenë të zbatueshme. Të drejtat e fituara për t'u ekzekutuar në një periudhë kohore në të ardhmen, në bazë të dispozitave të saj, do të rregullohen përmes një marrëveshjeje të posaçme.

Neni 34

Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje duhet të ratifikohet nga të dyja shtetet kontraktuese konform legjislacioneve të tyre përkatëse.

2. Shtetet kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën, në mënyrë diplomatike, mbi përmbylljen e procedurave për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, sipas kushtetutës dhe legjislacionit përkatës.

3. Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas marrjes në dorëzim, të njoftimit të fundit.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, shfuqizohet marrëveshja “Për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e së drejtës për pension”.

Nënshkruar në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, të dyja tekstet njëllonj të vlefshme.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË:

Delina Ibrahimaj

Ministër i Financave dhe Ekonomisë

PËR REPUBLIKËN E KOSOVËS:

Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

DEKRET

Nr. 13521, datë 28.3.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 23/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurime shoqërore”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Ilir Meta



LIGJ
Nr. 24/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
RREGULLAT E REGJIMIT TË
TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.3.2022.

Shpallur me dekretin nr.13522, datë 28.3.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS PËR RREGULLAT E REGJIMIT
TË TRAFIKUT LOKAL TË KUFIRIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në tekstin e mëtejshëm “Palët nënshkruese”,

duke vlerësuar marrëdhëniet miqësore, bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet dy vendeve;

duke marrë parasysh vullnetin për të forcuar dhe zhvilluar më tej bashkëpunimin dypalësh;

duke marrë në konsideratë synimin për të zhvilluar dhe promovuar bashkëpunimin midis qytetarëve që jetojnë në zonat kufitare, duke hapur vendkalime të reja kufitare, i cili, nga ana tjetër, siguron një bazë solide për zhvillimin e bashkëpunimit të mirë midis dy vendeve fqinje, me qëllim parandalimin e dukurive të krimit të organizuar dhe kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror,

duke u bazuar në vullnetin e mirë të të dyja palëve për lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së banorëve të zonës kufitare, janë pajtuar si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i regjimit të trafikut lokal kufitar dhe lejeve për këtë qëllim përgjatë kufirit, mes palëve nënshkruese.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Kjo Marrëveshje nuk cenon zbatimin e dispozitave të legjislacionit përkatës për të huajt që kanë të bëjnë, me:

- a) qëndrimin afatgjatë;
- b) kryerjen e aktiviteteve ekonomike; dhe
- c) çështjet doganore dhe tatimore.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimin të kësaj marrëveshjeje, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a) “kufiri tokësor” nënkupton kufirin e përbashkët tokësor midis dy vendeve;
- b) “zonë kufitare” nënkupton zonën që arrin jo më shumë se tridhjetë 30 kilometra nga kufiri tokësor;
- c) “banorë të zonës kufitare” nënkupton shtetasit e të dyja palëve nënshkruese, që janë banorë legjitim në zonën kufitare për një periudhë të caktuar në këtë marrëveshje, që duhet të jetë së paku 1 (një) vit. Në raste të jashtëzakonshme dhe të



arsyetuara, të specifikuara me këtë marrëveshje apo protokolleve të saj, periudha e qëndrimit prej më pak se 1 (një) vit po ashtu mund të konsiderohet si e përshtatshme;

d) “trafiku lokal kufitar” nënkupton kalimin e rregullt të pikës së kalimit kufitar apo edhe jashtë pikës së kalimit kufitar, ashtu siç përcaktohet me këtë marrëveshje, nga banorët e zonës kufitare, me qëllim të qëndrimit në zonën kufitare të palës tjetër nënshkruese, për arsye sociale, kulturore, arsimore, familjare, shëndetësore ose arsye të vërtetuara ekonomike, për një periudhë që nuk tejkalon afatin kohor të përcaktuar në këtë marrëveshje;

e) “leja e trafikut lokal kufitar” nënkupton një dokument të veçantë që u jep të drejtën banorëve të zonës kufitare të kalojnë pikën e kalimit të kufirit dhe jashtë tyre dhe të qëndrojnë në zonën kufitare të palës tjetër nënshkruese në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4 Zona kufitare

Zona kufitare e lëvizjes së lirë të banorëve me leje të trafikut lokal kufitar është deri në 30 km brenda territorit të palëve nënshkruese. Qendrat e banuara, të palëve nënshkruese, të zonës kufitare do të përcaktohen në protokollin zbatues të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5 Kriteret e hyrjes dhe qëndrimit

Banorët e zonës kufitare do të lejohen të kalojnë kufirin tokësor në bazë të regjimit të trafikut lokal kufitar, me kusht që:

- a) të posedojnë një dokument të vlefshëm identifikimi;
- b) të posedojnë lejen e trafikut lokal kufitar;
- c) të mos jenë subjekt i një mase të ndalimit të hyrjes në territorin e palëve nënshkruese ose që nuk përbëjnë kërcënim për rendin publik, sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo marrëdhëniet ndërkombëtare.

Banorët e zonës kufitare kanë të drejtë të qëndrojnë në zonën kufitare të palës tjetër nënshkruese, me kusht që kohëzgjatja e qëndrimit të tyre të mos jetë më e gjatë se 90 ditë brenda 180 ditëve.

Neni 6 Zonat e kalimit kufitar

a) Me qëllim lehtësimin e qarkullimit lokal kufitar, sipas parashikimeve të paragrafit 4, të nenit 5, të kësaj marrëveshjeje, zonat e kalimit kufitar, gjatë kufirit tokësor ndërmjet palëve, do të jenë:

- b) Padesh – Koshare,
- c) Zherkë – Babaj Bokës,
- d) Zogaj – Babaj Bokës,
- e) Dobrunë – Gërçina,
- f) Vlahën – Kushin,
- g) Kishaj – Planeja,
- h) Bardhoc – Breznë,
- i) Pakisht – Kërstec,
- j) Orgjost – Orogushtë,
- k) Borje – Globocice,
- l) Turaj – Restelicë.

Neni 7 Kontrolli kufitar

Në lejen e trafikut lokal kufitar, sipas regjimit të trafikut lokal kufitar, nuk aplikohet vendosja e vulës së hyrjes dhe daljes.

Gjatë kryerjes së verifikimit kufitar të banorëve kufitarë, që janë të pajisur me leje të trafikut lokal kufitar, nuk është e nevojshme të vërtetohet qëllimi i hyrjes ose posedimi i mjeteve të mjaftueshme financiare për jetesë.

Poseduesi i lejes së trafikut lokal kufitar duhet, në çdo kohë, të ketë me vete lejen e trafikut lokal kufitar dhe ta paraqesë sa herë që kërkohet nga zyrtari i autorizuar.

Në raste të caktuara dhe periodikisht, mund të kryhet edhe verifikim i plotë kufitar i banorëve kufitarë, që janë të pajisur me leje të trafikut lokal kufitar. Ky kontroll bëhet në intervale jo të rregullta kohore dhe për qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të lejes nga ana e poseduesit të saj.

Neni 8 Leja e trafikut lokal kufitar

Leja e trafikut lokal kufitar lëshohet nga autoritetet kompetente të Ministrisë së Brendshme të palëve nënshkruese.

Formati i lejes dhe përmbajtja e aplikimit për leje do të përcaktohet në protokollin zbatues të marrëveshjes.



Forma, elementet e sigurisë dhe specifikimet teknike të lejes do të miratohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm të të dyja vendeve.

Vlefshmëria territoriale e lejes së trafikut lokal kufitar është e kufizuar në zonën kufitare të përcaktuar në nenin 4, të kësaj Marrëveshjeje, dhe ka afat vlefshmërie prej 5 (pesë) vjetësh. Pas skadimit, leja e trafikut lokal kufitar mund të ripërtërihet sërish në afat deri në 5 (pesë) vjet, sipas kërkesës së palës.

Leja e trafikut lokal kufitar anulohet dhe shfuqizohet sipas kritereve të përcaktuara në protokollin e zbatimit.

Tarifat për aplikimin për pajisjen me leje të trafikut lokal kufitar do të përcaktohen me akt të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave të palëve respektive.

Leja është e vlefshme vetëm për lëvizjen dhe qëndrimin brenda zonës kufitare.

Për lejet e trafikut lokal kufitar, palët nënshkruese do të mbajnë regjistër të veçantë.

Neni 9

Vendkalimet e veçanta

Palët nënshkruese do të marrin masa për të lehtësuar kalimin e kufirit tokësor, për:

a) hapjen e vendkalimeve të veçanta kufitare, të destinuara vetëm për trafikun lokal kufitar, kur një gjë e tillë është e nevojshme;

b) hapjen e vendkalimeve kufitare të përkohshme, në raste të veçanta, duke marrë parasysh rrethanat lokale të banorëve që jetojnë në zonën kufitare;

c) caktimin si kalime kufitare dhe jashtë orarit të punës, në raste të veçanta, duke marrë parasysh rrethanat lokale të banorëve që jetojnë në zonën kufitare të palëve nënshkruese.

Neni 10

Legjislacioni i zbatueshëm

Personat që kalojnë kufirin tokësor dhe qëndrojnë në zonën kufitare të Palës tjetër në përputhje me regjimin e trafikut lokal kufitar, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje, duhet të respektojnë legjislacionin shtetëror të Palës tjetër.

Neni 11

Komisioni i Përbashkët i Ekspertëve

Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Palët nënshkruese do të formojnë Komisionin e Përbashkët të Ekspertëve (në tekstin e mëtejshëm “KPE”), të përbërë nga 3 (tre) përfaqësues nga secila palë.

KPE-ja harton protokolle teknike, për zbatimin e detyrimeve që dalin nga kjo marrëveshje, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes.

KPE-ja do të mbledhet të paktën 2 (dy) herë në vit dhe, nëse është e nevojshme, më shpesh, me kërkesë të njëres nga Palët nënshkruese.

KPE-ja do të monitorojë zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe do të zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që lindin gjatë interpretimit ose zbatimit e dispozitave të kësaj marrëveshjeje. Nëse në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, KPE-ja nuk mund të gjejë zgjidhje të pranueshme për të dyja palët nënshkruese, mosmarrëveshjet zgjidhen me negociata ndërmjet dy qeverive.

Neni 12

Dispozita përfundimtare

Kjo marrëveshje do të lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe do të hyjë në fuqi ditën e marrjes, përmes kanaleve diplomatike, të njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët vënë në dijeni njëra-tjetrën, se kanë përfunduar procedurat e brendshme ligjore të hyrjes në fuqi të saj.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e të dyja palëve nënshkruese, përmes shkëmbimit të notave verbale.

Kjo marrëveshje mund të denoncohet nga secila palë nënshkruese përmes rrugëve diplomatike.

Në këtë rast, kjo marrëveshje do të pushojë së ekzistuari 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerjen e saj.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në 2 (dy) kopje origjinale, secila në gjuhët zyrtare të palëve dhe gjuhën angleze, të gjitha tekstet autentike. Në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e marrëveshjes, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.



PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

Z. Bledar Çuçi
Ministër i Brendshëm

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet
në Fletoren Zyrtare.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS:
Z. Xhelal Sveçla
Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 13522, datë 28.3.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93
të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 24/2022, “Për ratifikimin e
marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të
Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së
Republikës së Kosovës për rregullat e regjimit të
trafikut lokal të kufirit”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 13519, datë 25.3.2022

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93
të Kushtetutës, si dhe të neneve 13,14, e 20, dhe në
vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me
propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë
të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Merita Jakup Mija
2. Mia Zini Memini
3. Ayrtan Zini Memini

DEKRET
Nr. 13523, datë 28.3.2022

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93
të Kushtetutës, si dhe të neneve 8, 20, e 23, pika 1,
të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me
propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre,
personave të mëposhtëm:

1. Resmije Ismajl Memaj (Elezkurtaj)
2. Qëndresa Rustem Gjura
3. Bashkim Shaban Karakushi
4. Mergim Zyber Xhoxhaj
5. Elona Astrit Shllaku
6. Kujtim Dinë Karakushi
7. Votim Nezir Parllaku
8. Emonë Nezir Parllaku
9. Ervis Shkumbin Shasivari
10. Burim Halit Tara
11. Apollon Burim Tara
12. Era Gazmend Nixha
13. Gjellbrime Zenel Fanaj
14. Hasije Baki Gavazaj (Hoxhaj)
15. Lirije Bajram Kurtaj (Islamaj)
16. Marina Nikolaevna Nikolovska (Nikollovskaja/Vlah/Vllah)
17. Liridon Ismail Cahani
18. Driton Man Fanaj
19. Petrit Sokol Nuhaj
20. Lirak Ibrahim Gjoshi
21. Dafina Enver Shasivari
22. Orland Enver Shasivari
23. Fluturiye Ebib Badalli (Islamaj)



24. Fatmire Bajram Berisha
25. Mira Gëzim Sallahuka
26. Jana Gëzim Sallahuka
27. Arijeta Ismet Yzeiri (Kyçyku/Kyqyku)
28. Muharrem Yalçin Burhanli
29. Vigan Orland Shasivari
30. Rina Gazmend Nixha Selimaj (Nixha)
31. Mary Cris Tinguban Ramon Diaz Azizi (Dionio)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

PRESIDENT REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr. 7, datë 18.3.2022

**PËR TRANSPARENCËN DHE
MONITORIMIN E ÇMIMIT PËR DISA
PRODUKTE USHQIMORE BAZË DHE
PRODUKTE TË TJERA TË LIDHURA
ME TO, SI PASOJË E SITUATËS SË
VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij akti normativ është përcaktimi i rregullave për transparencën dhe monitorimin e çmimit të disa produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg, në zbatim të pikës 3, të nenit 11, dhe të pikës 1, të nenit 17, të Kushtetutës.

Neni 2

Situata e veçantë

1. Situatë e veçantë, në kuptim të këtij akti normativ, janë të gjitha ato raste, të cilat krijojnë

situatë emergjente kur tregu i disa produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, sipas listës së përcaktuar nga Bordi, karakterizohet nga:

- a) rritja e ndjeshme e çmimit të tyre në treg;
- b) ulja në mënyrë të ndjeshme e importeve mesatare të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të lidhura me to, në krahasim me importet mesatare mujore të vitit kalendarik pararendës, për shkak të mungesave në tregun ndërkombëtar;
- c) mungesa e produkteve në mënyrë të argumentuar në një shkallë të tillë, që pasojat e pafavorshme të shkaktuara nga kjo situatë nuk mund të shmangen a të parandalohen pa përcaktimin e masave, në përputhje me këtë akt normativ;
- ç) çdo situatë tjetër e krijuar në tregun ndërkombëtar, e cila ka sjellë deformime në tregun vendas.

2. Situata e veçantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

**Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të
Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të
produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të
tjera të lidhura me to**

1. Me shpalljen e situatës së veçantë ngrihet dhe funksionon Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, në vijim, Bordi.

2. Bordi ka në përbërje:

- a) ministrin përgjegjës për financat dhe ekonominë në cilësinë e kryetarit;
- b) ministrin përgjegjës për bujqësinë;
- c) drejtorin e përgjithshëm të Tatimeve;
- ç) drejtorin e përgjithshëm të Doganave;
- d) drejtorin e përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- dh) 6 (gjashtë) përfaqësues nga shoqëritë e tregtimit të produkteve;
- e) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, në nivel drejtuesi të lartë;
- ë) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë, në nivel drejtuesi të lartë.

3. Bordi mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhjet e tij edhe përfaqësues të tjerë nga



institucione shtetërore, ekspertë të fushës apo grupe interesi.

4. Bordi merr vendime me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Në rastet e konfliktit të interesit të përfaqësuesve të shoqërive, ndaj të cilave merret masë administrative, përfaqësuesi merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjen e Bordit dhe përjashtohet nga vendimmarrja.

5. Sekretariati i Bordit përbëhet nga struktura përgjegjëse për politikën ekonomike dhe fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe përfaqësues nga strukturat e administratës doganore.

6 (gjashtë) përfaqësuesit e subjekteve të përzgjedhura nga shoqatat e biznesit dhe grupet e interesit, dërgojnë emrat e përfaqësuesve të tyre te sekretariati i Bordit.

7. Mbledhjet e Bordit thirren me kërkesë të kryetarit të Bordit. Njoftimi për mbledhje duhet të kryhet të paktën 2 (dy) orë para mbledhjes.

8. Mbledhjet e Bordit, në cilësinë e organit kolegjial gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së situatës së veçantë, realizohen edhe *on-line*, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik/telepunës.

Neni 4

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit

Bordi ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

a) të miratojë listën e produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, për të cilat zbatohet situata e veçantë;

b) të zbatojë metodologjinë e përcaktuar për vendosjen me transparencë të plotë të marzhit të fitimit;

c) të vendosë marzhin e fitimit në bazë të monitorimit të çmimeve për produktet ushqimore bazë dhe produktet e tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg;

ç) të njoftojë në mënyrë periodike, sipas vendimeve të Bordit, marzhin e fitimit, të cilat publikohen në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe në një seksion të veçantë në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe bujqësinë. Vendimet e marra nga Bordi i fillojnë efektet ditën pasardhëse ose sipas përcaktimit të vendimit të Bordit;

d) t'i propozojë strukturës përgjegjëse marrjen e masave administrative, sipas shkronjës “c”, të nenit 7, dhe pikës 3, të nenit 8, të këtij akti normativ, që

duhet të ndërmerren ndaj subjekteve në rast shkeljeje të parashikimeve të këtij akti normativ;

dh) çdo kompetencë tjetër që vlerësohet e nevojshme, në bazë të këtij akti normativ.

Neni 5

Strukturat për monitorimin e zbatimit të vendimeve të Bordit

Marzhi i fitimit i vendosur nga Bordi është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjitha subjektet dhe zbatimi i tyre monitorohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet verifikimit të faturave të lëshuara nga subjektet gjatë periudhës së situatës së veçantë të krijuar në treg. Sipas rastit, Bordi mund të vendosë krijimin e një task-force, me përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Neni 6

Vlera e produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to

1. Bordi çdo javë monitoron vlerën e çmimit të produkteve, sipas listës së miratuar prej tij, dhe vendos marzhin e fitimit.

2. Vlera e çmimit përbëhet:

a) nga çmimi i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas origjinës së produkteve;

b) nga marzhi i fitimit të përcaktuar nga Bordi, për subjektet e importit dhe prodhimit, mbi çmimin e përlogaritur sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, në të cilin aplikohen edhe taksat e tarifave, sipas legjislacionit në fuqi;

c) ndërsa për subjektet e tregtimit me pakicë, nga marzhi i fitimit i përcaktuar nga Bordi, mbi çmimin e përlogaritur, sipas shkronjave “a”, dhe “b”, të kësaj pike, në të cilin aplikohen edhe taksat e tarifave, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Masat e veçanta administrative

Në rast të mosrespektimit të marzhit të fitimit të vendosur nga Bordi për produktet ushqimore bazë dhe produktet e tjera të lidhura me to zbatohen sanksionet e mëposhtme:



a) Subjektet e tregimit me shumicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të lidhura me to dënohen me gjobë, në masën 10 (dhjetë) milionë lekë;

b) Subjektet e tregimit me pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të lidhura me to dënohen me gjobë, në masën 2 (dy) milionë lekë;

c) Në rast përsëritjeje, masave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, i shtohet edhe pezullimi i ushtrimit të aktivitetit dhe sekuestrimi i produkteve në gjendje inventari.

Neni 8

Masat me karakter detyrues

1. Të gjitha subjektet, që importojnë dhe/ose prodhojnë produkte, objekt i këtij akti normativ, janë të detyruara të marrin masa dhe të ofrojnë furnizim të pandërprerë, në përputhje me vendimet e Bordit.

2. Të gjitha subjektet që tregtojnë produkte me shumicë, objekt i këtij akti normativ, të nevojshme për furnizimin e popullatës, janë të detyruara të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë, për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg. Produktet e blera, me qëllim furnizimin e popullatës, në rastet kur me përfundimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, nuk janë shitur në tregun e lirë, mund t'i shiten Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, me kërkesë të subjektit dhe sipas faturës me të cilën këto produkte janë blerë. Rregullat dhe procedurat për blerjen e këtyre produkteve nga Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit të Mbrojtjes.

3. Mosmarrja e masave nga subjektet private, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, dënohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 7, të këtij akti normativ, dhe këto subjekte përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare nga Agjencia e Prokurimit Publik.

4. Të gjitha institucionet shtetërore, që do të zhvillojnë procedura prokurimi për produktet e miratuara me vendim Bordi, duhet të mbajnë në

konsideratë parashikimet e këtij akti normativ, gjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës së veçantë.

Neni 9

Organet kompetente për dhënien e masave administrative

1. Të drejtën e dhënies së masave administrative me gjobë, sipas përcaktimeve të nenit 7, të këtij akti normativ, e ka Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shkeljet e konstatuara, që lidhen me masat administrative me gjobë, sipas përcaktimit të nenit 7, të këtij akti normativ, vepron me dhënien e masës përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve nga data e konstatimit të shkeljeve.

3. Shkeljet e konstatuara nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, që lidhen me masën administrative me gjobë, sipas përcaktimit të nenit 7, të këtij akti normativ, i dërgohen brenda 24 (njëzet e katër) orëve Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila vepron brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës, me dhënien e masës përkatëse të propozuar.

4. Shkeljet e konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, që lidhen me masën administrative “pezullim aktiviteti dhe sekuestrim të produkteve gjendje inventari”, i dërgohen brenda 48 (dyzet e tetë) orëve Bordit. Me marrjen e kërkesës, Bordi merr vendim lidhur me masën administrative “pezullim aktiviteti dhe sekuestrim të produkteve gjendje inventari”. Vendimi i Bordit i dërgohet për ekzekutim dhe fillimin e procedurës për pezullim aktiviteti Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe administratës tatimore për sekuestrimin e produkteve në gjendje inventari. Akti administrativ i pezullimit të aktivitetit dhe sekuestrimit të produkteve gjendje inventari merret nga organi kompetent brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e konstatimit të shkeljes.

5. Gjocat e dhëna, sipas këtij akti normativ, përbëjnë titull ekzekutiv. Modeli i tyre përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

6. Gjocat e mbledhura, sipas këtij akti normativ, derdhen 100% në buxhetin e shtetit.



7. Shqyrtimi dhe dhënia e masave administrative bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 10
Kohëzgjatja dhe zbatimi

1. Parashikimet e këtij akti normativ zbatohen për atë kohë sa zgjat periudha e situatës së veçantë të krijuar në treg.

2. Zbatimi i parashikimeve të këtij akti normativ fillon me shpalljen e situatës së veçantë, me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfundimi i situatës së veçantë përcaktohet me vendim të Bordit.

3. Në çdo rast, ky akt normativ nuk përjashton aplikimin e legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive apo akteve të tjera ligjore, për atë kohë sa nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij akti normativ.

Neni 11
Ankimi ndaj masave administrative

Masat administrative me gjobë, të vendosura sipas këtij akti normativ, ankimohen sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, ndërsa masat administrative me pezullim aktiviteti dhe sekuestrim të produkteve gjendje inventari ankimohen në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12
Dispozitë kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ shpallet edhe situata e veçantë, në kuptim të nenit 2, të këtij akti normativ, dhe fillojnë të zbatohen të gjitha dispozitat e këtij akti normativ.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 71, datë 23.3.2022

**PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
TË KOMPETENCAVE**

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM-së nr. 58 datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, nenit 26 të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave, të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror, z. Agron Cani.

2. Z. Agron Cani i delegohen kompetencat si më poshtë:

- ndjek dhe zbaton “Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (i ndryshuar);

- ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;

- ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;

- merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 28.3.2022 deri më 1.4.2022.

4. Z. Agron Cani nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.



7. Ky urdhër hartohet në 2 (dy) kopje të njëjta, një për Protokoll-Arkivin dhe një për drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrat Qendror.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

VENDIM
Nr. 3, datë 17.2.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese E Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare
Marsida Xhaferllari	anëtare
Fiona Papajorgji	anëtare
Altin Binaj	anëtar
Përparim Kalo	anëtar
Sonila Bejtja	anëtare
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.2.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 2 (L) 2021 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Laert Kola

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia Shtetërore e Kadastrës,

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Bashkia Fier, Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimit nr. 25/22, datë 17.6.2021, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi parashtrimet e kërkuarit Laert Kola, i cili

Faqe | 7120

ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet dhe qëndrimin e subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Drejtorisë Vendore të ASHK-së, Fier, bashkisë Fier, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 132, datë 14.2.1996 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve (vendimi nr. 132/1996 i KKKP-së) është vendosur, ndër të tjera, njohja e pronësisë së J.K. për një truall me sipërfaqe 5000 m², të ndodhur në fshatin Grecalli, komuna Qendër, Fier dhe kompensimi me truall fizik i trashëgimtarëve të tij ligjorë.

2. Në datën 11.12.2015 kërkuar, trashëgimtar i të ndjerit J.K., i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesëpadi me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, regjistrimit e pasurisë nr. 128/1, ZK 1453, terren sportiv, regjistruar sipas VKM nr. 509, datë 6.7.2011 në emër të Komunës Qendër Fier. Detyrimin e ZVRPP Fier të fshijë nga regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme subjektin Komuna Qendër Fier për pasurinë nr. 128/1, ZK 1453, vol. 3, faqe 203. Detyrimin e ZVRPP Fier të regjistrojë pronarët sipas vendimit nr. 132, datë 14.2.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve për pasurinë nr. 128/1, ZK 1453, vol. 3, faqe 203. Të shfuqizojë aktin administrativ të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nr. 128/1, ZK 1453, vol. 3, faqe 203 në emër të subjektit Komuna Qendër Fier. Sigurimin e padisë.”. Në përfundim të gjykimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 447, datë 31.3.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadi.

3. Kërkuar ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 447, datë 31.3.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 15037 (31025-04490-86-2016) akti, datë 9.9.2016.

4. Në kushtet kur ankimi i tij drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit nuk ishte shqyrtuar ende, në datën 14.12.2020, kërkuar i është drejtuar



Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt: *“Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit. Kohëzgjatjen e paarsyeshme në procedurat e gjyqimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.”*

5. Me vendimin nr. 25/22, datë 17.6.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit dhe pushimin e gjyqimit në lidhje me kërkimin për shpërblimin e dëmit, pasi ka konstatuar se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Ndër të tjera, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes ishte rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalonte rastin konkret, se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh duke krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore, por që këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme të krijuar nga procesi i reformës. Parimi i gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Në asnjë rast cilësia e procesit të rregullt ligjor dhe e vendimmarrjes së gjykatës nuk duhet të sakrifikohet për *“sasinë e afatit të arsyeshëm”* ose edhe ekonominë gjyqësore në tërësi (*shih paragrafët 23, 27 dhe 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

6. Në datën 12.10.2021 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 25/22, datë 17.6.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

7. Me vendimin e datës 5.11.2021, Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31 të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 7.12.2021, ka vendosur ta kalojë atë për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

8. Gjykata Administrative e Apelit, në përgjigje të kërkesës së Gjykatës, me shkresën e datës 28.12.2021, ka informuar se: i) pranë saj ushtrojnë detyrën 5 gjyqtarë; ii) ngarkesa e tyre varion nga 2683-4378 çështje për çdo gjyqtar; iii) janë duke u

shqyrtuar çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017; iv) deri në datën 15.12.2021 nga ajo gjykatë janë dhënë 623 vendime themeli e deri në muajin korrik 2021 gjykata ka funksionuar me 9 gjyqtarë, ndërsa gjyqtarja A.G. është shkarkuar në datën 23.11.2021 me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA); v) çështja e kërkuarit ka qenë në ngarkim të gjyqtarit B.Sh., i cili nuk e ushtron më detyrën e gjyqtarit, sipas vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) nr. 361, datë 25.3.2021, ndërsa pas procedurave të rishortimit në datën 30.4.2021, çështja i ka kaluar për gjykim gjyqtarës A.G., e cila e ka planifikuar atë për gjykim në dhomë këshillimi në datën 10.11.2021, seancë e cila nuk është zhvilluar. Gjyqtarja A.G. është shkarkuar me vendim të KPA-së në datën 23.11.2021. Pas procedurave të shortit në datën 16.12.2021, çështja i ka kaluar gjyqtarës B.H.

9. Në datën 7.2.2019 është miratuar ligji nr. 111/2018 “Për kadastrën”, me të cilin kompetencat e ZQRPP-së dhe ZVRPP-së Fier i kanë kaluar respektivisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe drejtorisë vendore të saj, Fier. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. Kërkuari në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

10.1 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi arsyetimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është bërë tej afatit 7-ditor të parashikuar në nenin 42, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), shkelje për të cilën Gjykata e Lartë nuk është shprehur në vendimin e saj. Po kështu, gjyqtari fillestar, relator i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së tij për kriteret që përcaktojnë radhën e shqyrtimit të çështjeve, ndërkohë që çështja e tij nuk është shqyrtuar ende nga kjo gjykatë, ndonëse janë tejkaluar afatet e parashikuara në nenin 48, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin



399/2, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Nga momenti i regjistrimit të ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit kanë kaluar afërsisht 5 vjet e 3 muaj pa një vendimmarrje nga kjo gjykatë. Vendimi i Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave është marrë 6 muaj pas depozitimit të kërkesës, në kundërshtim me nenin 399/7, pika 2, të KPC-së që parashikon afatin 45-ditor për shqyrtimin e saj. Vonesa e kësaj gjykate në marrjen në shqyrtim të kërkesës, duke i kërkuar firmosjen e saj nga një avokat, si dhe paraqitjen e dokumenteve plotësuese, ka sjellë ndryshimin e rrethanave të çështjes. Gjyqtari relator në Gjykatën Administrative të Apelit është shkarkuar nga KPK-ja dhe për çështjen e tij është caktuar si relatore tjetër gjyqtare, e cila nuk ka pasur mundësi ta gjykojë atë brenda afatit ligjor. Referimi i Gjykatës së Lartë në nenin 474 të KPC-së për paraqitjen e kërkesës është i gabuar, pasi kjo dispozitë ka të bëjë me paraqitjen e rekursit, ndërkohë që kërkesa drejtuar asaj gjykate për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm është bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, që nuk parashikojnë një detyrim të tillë.

10.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk është shprehur për pretendimet e tij në lidhje me vonesën në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, si dhe për afatet e përcaktuara në ligjin nr. 49/2012 për gjykimin e çështjeve administrative. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë, se vonesat në gjykimin e çështjes fillojnë që nga momenti që ka filluar procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, bie ndesh me parashikimet e ligjit nr. 42/2012, që përcaktojnë afatin 30-ditor të gjykimin të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky arsyetim vë në pikëpyetje sigurinë juridike, pasi çdo gjyqtar mund të mbajë me vite dosje pa i gjykuar, ndërkohë që palët nuk kanë asnjë mundësi ankimi për këto vonesa. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk është shprehur për masat e marra për përshpejtimin e gjykimin të ankimeve, ndërsa argumenti i gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit se çështjet gjykojnë sipas radhës, nuk është i bazuar në një normë ligjore. Për më tepër, në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Lartë gabon rëndë duke u shprehur për themelin e çështjes dhe

për vendimin e arsyetuar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, pasi ky vendim nuk është përfundimtar.

10.3 *Së drejtës së mbrojtjes*, pasi relatorja në Gjykatën Administrative të Apelit nuk e ka informuar për informacionin që i ka dërguar Gjykatës së Lartë për ecurinë e çështjes së tij të themelit dhe ky informacion nuk i është vënë në dispozicion as nga Gjykata e Lartë.

11. ***Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit***, ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkuarit si vijon:

11.1 Kërkuari ka gabuar në përcaktimin e ndërgjyqësisë në gjykimin kushtetues, duke thirrur si subjekte të interesuara në këtë gjykim Gjykatën e Lartë, Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Këto gjykata nuk mund të thirren për të dhënë shpjegime për vendimmarrjet e tyre, pasi kjo do të cenonte pavarësinë e tyre, duke vendosur një regjim hierarkik mes sistemit gjyqësor dhe atij kushtetues.

11.2 Kërkuari kundërshton një praktikë ende në shqyrtim në gjykatat e sistemit gjyqësor. Në këtë kuptim, ai nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi, në kushtet kur shqyrtimi i çështjes së themelit nuk ka përfunduar ende në Gjykatën e Lartë, ai nuk i ka shteruar mjetet në dispozicion, në kuptim të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000. Në mënyrë që kërkuari të legjitimohet në këtë proces do të duhet të ketë më parë një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe të mos ketë mjete të tjera në dispozicion të tij. Konstatimi i tejzgjatjes së procedurave nuk përbën juridiksion kushtetues, për sa kohë që çështja e themelit është ende në shqyrtim.

11.3 Për sa i përket pretendimit të kërkuarit për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimin, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është ezauruese dhe e mbështetur në nenet 399/5 e 399/6 të KPC-së, duke respektuar kufijtë e objektit të kërkesës dhe dispozitave që rregullojnë këtë kërkim. Gjykata e Lartë, pasi ka konstatuar se çështja e kërkuarit e ka kaluar afatin 1-vjeçar të shqyrtimit në apel, ka marrë në shqyrtim edhe shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e këtij procesi. Me të drejtë, ajo ka vlerësuar se vonesa në shqyrtimin e çështjes është pasojë e një problematike të përgjithshme, të shkaktuar si rrjedhojë e reformës në drejtësi, që tejkalon rastin konkret. Këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën



e përgjithshme që krijon procesi i reformës. Në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator, si dhe ngarkesa e këtij të fundit në raport me gjyqtarët e tjerë. Gjyqtari relator fillestar në Gjykatën Administrative të Apelit është ndryshuar, ndërkohë që gjyqtari tjetër relator, të cilit i ka kaluar çështja, pas njohjes me kërkesën e kërkuarit për përshpejtimin e gjykimit, është shprehur se për çështjen e tij do të ndiqej radha si për të gjitha çështjet e tjera. Ky qëndrim është arsyetuar me faktin se si gjyqtari relator, ashtu edhe trupi gjyqësor kishin ngarkesë të madhe çështjesh që prisnin radhën e shqyrtimit të gjykimit të tyre. Mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime e qëndrime abuzive të gjyqtarit, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar kriteret transparente për shqyrtimin e çështjeve sipas rendit kronologjik të paraqitjes së tyre.

11.4 Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është ezaurues dhe i plotë, si dhe u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuarit. Ai është logjik, koherent, i strukturuar, përmbush kërkesat për një arsyetim të plotë ligjor dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, për sa u përket elementeve që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor i arsyetuar.

12. Subjektet e interesuara, bashkia Fier, ASHK-ja dhe Drejtoria Vendore e ASHK-së, Fier nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, 134 pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi

kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuari, në thelb, ankohet për gjykimin përtej afatit të arsyeshëm të çështjes së tij në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili ende nuk ka përfunduar, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën e tij për përshpejtimin e procedurave.

15. Për rrjedhojë, kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor që ai kundërshton dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individ i përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individ pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuari, i cili, para se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike efektive, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve, që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 31, datë 4.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Përpara analizës së kriterit të shterimit të mjeteve ligjore efektive në çështjen konkrete, Gjykata, fillimisht, vlerëson të vërë në dukje jurisprudencën e saj në lidhje me shqyrtimin e



kërkesave për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm.

18. Fillimisht, kërkesat për gjykimin ose për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm nuk janë pranuar për shqyrtim nga Gjykata, me arsyetimin se nuk hynin në juridiksionin kushtetues. Gjykata e ndryshoi jurisprudencën e saj në vitin 2006, pas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në çështjen Qufaj kundër Shqipërisë, datë 18.9.2004, duke e konsideruar ekzekutimin e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm si pjesë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në vijim, Gjykata, në bazë të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, ka vlerësuar, gjithashtu, se mund të merren në shqyrtim prej saj edhe kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjyimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Me ndryshimet që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 38/2017*), të cilat hynë në fuqi më 5.11.2017, ligji procedural parashikon mjete ligjore nëpërmjet të cilave, individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për gjykimin ose për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, brenda afatit të arsyeshëm. Duke iu referuar këtyre ndryshimeve ligjore, Gjykata ka vlerësuar se nuk mund të investohet për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Pavarësisht kësaj qasjeje, individët kanë paraqitur sërish, drejtpërdrejt në Gjykatë, kërkesa të kësaj natyre, me pretendimin se mjeti ligjor që duhet të shterojnë, sipas dispozitave të reja të KPC-së, nuk është efektiv, si dhe duke parashtruar se edhe pse e kanë shteruar formalisht këtë mjet, duke kërkuar konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, nuk kanë marrë përgjigje nga ana e gjykatave të zakonshme. Nga shqyrtimi i këtyre rasteve, Gjykata, në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, ka pranuar se, në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret, duke analizuar nëse mjeti juridik përshpejtues është real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë, pra që ai nuk është një mundësi e tërthortë për kërkuesin. Në këtë kuptim, kur kërkesa për përshpejtimin e procedurave nuk i ka shërbyer qëllimit të saj - përshpejtimit të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes, atëherë ky mjet juridik nuk ka qenë *efektiv* në praktikë. Për rrjedhojë, në këto raste Gjykata ka vlerësuar se kriteri i shterimit të mjetit juridik është përmbushur (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në zhvillimin e kësaj jurisprudence, Gjykata ka mbajtur në konsideratë dy faktorë të rëndësishëm. I pari lidhet me faktin se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë ende një qëndrim të konsoliduar për mjetet juridike të parashikuara nga KPC-ja, duke qenë se rregullat ligjore respektive janë relativisht të reja. Ndërsa, faktori i dytë ka të bëjë me qëndrimin e GJEDNJ-së, e cila është shprehur se në vlerësimin e efektivitetit të mjetit juridik që lidhet me vonesat procedurale është vendimtare të përcaktohet nëse ka mundësi që kërkuesit t’i sigurohet dëmshpërblim i drejtpërdrejtë dhe i shpejtë, në vend të mbrojtjes së tërthortë të të drejtave të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se mjeti juridik, kërkesa për përshpejtim, nuk ka qenë efektiv në rastin e tij, pasi, në shqyrtimin e kësaj kërkesë, Gjykata e Lartë ka mbajtur qasje formaliste. Sipas tij, vonesa e kësaj gjykate në marrjen në shqyrtim të kërkesës, duke i kërkuar firmosjen e saj nga një



avokat, si dhe paraqitjen e dokumenteve plotësuese, ka sjellë ndryshimin e rrethanave të çështjes së themelit, pasi gjyqtari relator në Gjykatën Administrative të Apelit është shkarkuar nga KPK-ja dhe për çështjen e tij është caktuar si relatore tjetër gjyqtare, e cila nuk ka pasur mundësi ta gjykojë atë brenda afatit ligjor. Po sipas kërkuessit, vendimi për këtë kërkesë është marrë nga Gjykata e Lartë pas 6 muajve, në kundërshtim me nenin 399/7, pika 2, të KPC-së që parashikon afatin 45-ditor për shqyrtimin e saj. Në përfundim, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se vonesat në shqyrtimin e çështjes së themelit nuk kanë ardhur si pasojë e qëndrimeve subjektive të gjyqtarit relator, por për shkak të problematikës së përgjithshme të krijuar si rrjedhojë e reformës në drejtësi.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kërkesa për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit dhe përsheptimin e procedurave ndryshon nga rekursi, në pikëpamje të përmbajtjes, të aksesit dhe sidomos të shpejtësisë që duhet të karakterizojë marrjen në shqyrtim të saj. Si i tillë, ky mjet juridik nuk duhet të trajtohet me formalizëm të tepruar nga punonjësit e administratës gjyqësore, veprimet ose mosveprimet e parregullta të së cilës nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës). Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë ka detyrimin të sillt në atë mënyrë që kërkesa për përsheptim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 37, datë 5.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, për sa u përket pretendimeve të kërkuessit për formalizmat e Gjykatës së Lartë në marrjen në shqyrtim të kërkesës së tij për përsheptim, Gjykata eidenton se me shkresat nr. 25 prot., datë 29.12.2020 dhe nr. 14/1 prot., datë 13.1.2021 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, kërkuessit i është kërkuar, ndër të tjera, që për efekt të identifikimit të saktë të çështjes gjyqësore, bazuar në nenin 399/5, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, kjo kërkesë të plotësohej me dokumentet e nevojshme me qëllim të përcaktimit të objektit të mosmarrëveshjes. Po kështu, Gjykata konstaton se kërkesa për përsheptim është regjistruar në Gjykatën e Lartë që në momentin e paraqitjes së saj në datën 14.12.2020 (*shih paragrafin*

9 të vendimit të Gjykatës së Lartë) dhe procedura e kërimit të dokumentacionit plotësues nuk rezultoi që të jetë kryer në kundërshtim me legjislacionin procedural në fuqi, konkretisht me dispozitat e nenit 399/5 të KPC-së, që parashikojnë dokumentet plotësuese që duhet të përmbajë një kërkesë e tillë.

25. Më tej, Gjykata vëren se në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së kërkuessit për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e saj, edhe pse ka konstatuar se kishte kaluar afati i shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit (*shih paragrafin 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në thelb, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se mosveprimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive dhe se nuk ka zvarritje të qëllimshme nga gjyqtari relator, por, në kuptim të nenit 399/2, pika 2, të KPC-së, gjykata e shkallës së dytë është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës, akumulimit të çështjeve dhe shkurtimeve të numrit të gjyqtarëve në sistem, pasojë këto të reformës në drejtësi (*shih paragrafët 20 - 28 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

26. Lidhur me argumentin e përdorur nga Gjykata e Lartë si shkak objektiv që shkarkon gjykatat e zakonshme nga përgjegjësia për tejkalimin e afatit të arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve, Gjykata është shprehur se, ndonëse interpretimi rast pas rasti i ligjit – konkretisht nenit 399/2 të KPC-së, i takon vetë Gjykatës së Lartë, qasja për të mos llogaritur efektet e reformës së drejtësisë në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave, nuk përputhet me standardin e “afatit të arsyeshëm” të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35 datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkesa për përsheptimin e procedurave në rastin e kërkuessit e ka humbur qëllimin e saj – përsheptimin e procedurave ose parandalimin e tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të ankimit të tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Pra, mjeti juridik “kërkesa për përsheptimin e procedurave”, që kërkuessit ka pasur në dispozicion, sipas nenit 399/6 të KPC-së, në rastin e tij nuk ka qenë *efektiv*, në kuptimin që nuk ka qenë real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë.



27. Për sa më lart, ndonëse formalisht kërkuesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon ligji, Gjykata vlerëson se nga mënyra se si është trajtuar ky mjet nga Gjykata e Lartë, ai mbetet sërish një mjet ankimi joefektiv. Në këtë kuptim, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual, për rrjedhojë në çështjen konkrete përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike.

28. Gjykata evidenton, gjithashtu, se në rastin konkret është vënë në dyshim mundësia që kërkesa për përshpejtimin e procedurave ka për t'iu përgjigjur në shkallën e duhur nevojës për të garantuar të drejtën e individit për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në raport me mundësitë reale të sistemit gjyqësor, për shkak të volumit të lartë të çështjeve, si dhe burimeve njerëzore dhe infrastrukturore të tij në tërësi. Për pasojë, është e rëndësishme të theksohet se çështja konkrete, për shkak të veçantisë së rrethanave të saj, bën pjesë në situatat përjashtimore, pasi, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

29. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 17.6.2021 dhe ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.10.2021, pra brenda afatit 4-mujor, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

30. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata çmon të evidentojë fillimisht se kërkuesi, në ankimin e tij kushtetues, krahas pretendimit për shqyrtimin e vonuar të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit, ka kundërshtuar edhe vendimin e Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për përshpejtim, duke pretenduar, në thelb, se i ka cenuar atij të drejtën kushtetuese për proces të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata ka arsyetuar më lart se mënyra se si ka vepruar Gjykata e Lartë e ka bërë këtë lloj mjet ankimi joefektiv në rastin e kërkuesit (*shih paragrafët 26-27 të këtij vendimi*). Për rrjedhojë, ajo nuk do të analizojë veçmas këtë kërkim, por do ta konsiderojë atë në funksion të pretendimit thelbësor të kërkuesit për

cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda afatit të arsyeshëm. Në vijim, Gjykata çmon se është i pabazuar prapësimi i subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, se “kërkesa nuk përbën materie kushtetuese në kushtet kur çështja e kërkuesit është ende në shqyrtim”, pasi objekt i ankimit kushtetues individual është ecuria e gjykimit që lidhet me kërkimin e tij për pavlefshmërinë absolute të aktit të regjistrimit të pasurisë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 6.7.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qendër Fier të Qarkut Fier” dhe regjistrimin e pronës së tij sipas vendimit nr. 132/1996 të KKKP-së, gjykim, i cili është duke u zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit. Si përfundim, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit përfshihet në juridiksionin kushtetues, prandaj në vijim do të analizojë bazueshmërinë e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

31. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi arsyetimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është bërë tej afatit 7-ditor, të parashikuar në nenin 42, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, çka ka çuar në vonesa në shqyrtimin e çështjes së tij në apel. Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka shqyrtuar ende çështjen e tij, ndonëse nga momenti i regjistrimit të ankimit e deri në paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese kanë kaluar afërsisht 5 vjet e 3 muaj.

32. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se kërkimi për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes duhet të rrëzohet, pasi vonesa ka ardhur si rezultat i faktorëve objektivë.

33. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të



arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

34. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendimi. Te kohëzgjatja e përgjithshme e gjykimit nuk përfshihen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, sepse barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuarit për vonesën në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë tej afatit 7-ditor, të parashikuar në nenin 42, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi kërkuarisi nuk arriti të provonte këtë pretendim para Gjykatës.

36. Gjykata konstaton se thelbi i mosmarrëveshjes që po gjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit lidhet me mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, prandaj ai gjykim përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 42 të Kushtetutës. Ankimi i kërkuarit, që ka vënë në lëvizje gjykimin në shkallë të dytë, është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 9.9.2016 dhe ndonëse kanë kaluar rreth 5 vjet e 6 muaj, kërkuarisi ende nuk ka një vendimarrje për çështjen e tij.

37. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata sjell në vëmendje se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se gjykata e apelit e shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së tij nga gjykata ku është paraqitur. Ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave mbi mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”), që zgjatet edhe me 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (neni 109 i ligjit nr. 38/2017).

38. Duke konsideruar afatet ligjore në raport me kohëzgjatjen e çështjes së kërkuarit, çështje e cila ka

qenë në proces në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KPC-së, Gjykata vlerëson se *prima facie* gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën Administrative të Apelit është tejzgatur, fakt që pranohet edhe nga palët në proces. Konkretisht, kërkuarisi pretendon se në gjykimin e çështjes së tij nuk janë respektuar afatet ligjore, duke u zgatur në mënyrë të paarsyeshme. Ndërsa subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, është shprehur se ndonëse ka tejzgatje të gjykimit, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuarit, duke arsyetuar se vonesa është rrjedhojë e efekteve të reformës në drejtësi, që përbën një problematikë që tejkalon rastin konkret. Në këtë situatë, për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit është e paarsyeshme, pra nëse kërkuarisi i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i) sjelljen e kërkuarit; ii) kompleksitetin e çështjes; iii) si dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Sjellja e kërkuarit

39. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes së kërkuarit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuarisi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa për gjykimin e çështjes, duke iu drejtuar edhe gjyqtarit relator në Gjykatën Administrative të Apelit me kërkesë për informacion për kriteret dhe procedurat e gjykimit të çështjeve. Po kështu, në datën 14.12.2020, kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.



41. Në përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret, sjellja e kërkuarit nuk është bërë shkak për vonesat në shqyrtimin e çështjes së tij.

ii. Komplexiteti i çështjes

42. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objekti, faktet e kundërshtuara, volumi dhe natyra e provave, lloji dhe ndërthurja e ligjeve të zbatueshme, si dhe numri i palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, sepse balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 16, datë 16.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Në rastin konkret, Gjykata vëren se sipas informacionit të paraqitur për çështjen nga Gjykata Administrative e Apelit, ankimi i kërkuarit është regjistruar në këtë gjykatë në datën 9.9.2016 dhe fillimisht është caktuar si relator i çështjes gjyqtari B.Sh., i cili është shkarkuar nga detyra në datën 25.3.2021 me vendim të KPK-së. Pas procedurës së rishortimit, si relatore e çështjes është caktuar gjyqtarja A.G., e cila është shkarkuar nga detyra në datën 23.11.2021, me vendim të KPA-së. Më pas, çështja i ka kaluar gjyqtarës B.H. dhe deri në datën 28.12.2021 nga Gjykata Administrative e Apelit nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera për çështjen (*shih paragrafin 8 të këtij vendimi*).

44. Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, që rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në seancë gjyqësore publike dhe, krahas kërkuarit, në gjykim janë thirrur ZRPP-ja, Fier, si person i paditur, si dhe bashkia Fier e Avokatura e Shtetit, zyra vendore Vlorë, si persona të tretë. Po kështu, Gjykata konstaton se procedurat përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë kanë zgjatur përafërsisht 3 muaj e gjysmë, si dhe se Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje për ankimin e kërkuarit, në cilësinë e palës paditëse.

45. Për sa më lart, Gjykata çmon se kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesat në gjykimin në shkallë të dytë prej rreth 5 vjetësh e 6 muaj.

iii. Sjellja e autoriteteve

46. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin

detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, për shkak se relatorja në Gjykatën Administrative të Apelit nuk e ka informuar për informacionin që i ka dërguar Gjykatës së Lartë për ecurinë e çështjes së tij, si dhe se ky informacion nuk i është vënë në dispozicion as nga Gjykata e Lartë, Gjykata eidenton se me shkresën nr. 1672 prot., datë 21.5.2021 të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 399/7 të KPC-së, është marrë mendimi me shkrim i gjyqtarës relatore. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, Gjykata e Lartë nuk ka detyrim ligjor që, me nismën e saj, t'i njoftojë këtë mendim me shkrim kërkuarit, megjithatë ai ka të drejtë të njihet me aktet në dosje, të drejtë të cilën mund ta ushtrojë ose duke paraqitur kërkesë pranë gjykatës që ka aktet e çështjes, ose duke u paraqitur fizikisht atje. Në kushtet kur nuk provohet që një e drejtë e tillë t'i jetë mohuar, Gjykata vlerëson se pretendimi i tij për sjelljen e Gjykatës së Lartë në këtë drejtim nuk qëndron.

48. Në drejtim të pretendimeve për kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata vëren se gjykimi administrativ i ankimit të kërkuarit vazhdon prej rreth 5 vjetësh e 6 muaj pa vendimmarrje në shkallë të dytë, ndonëse ligjvënësi i ka përcaktuar gjykimet administrative si të shpejta, duke parashikuar afate të shkurtra procedurale në ligjin nr. 49/2012 (*shih paragrafin 37 të këtij vendimi*). Kohëzgjatja e gjykimit administrativ e ka vënë kërkuarin në pamundësi për të ushtruar lirisht të drejtën e pronës, të përfituar përmes vendimit nr. 132/1996 të KKKP-së.

49. Kërkuari ka parashtruar se Gjykata e Lartë e ka mbështetur arsyetimin e vonesës së gjykimit të çështjes së tij, ndër të tjera, me ngarkesën e gjykatave, por kjo nuk mund të justifikojë cenimin e së drejtës kushtetuese të tij. Ndërsa, subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se



vonesa në gjykimin e çështjes së kërkuessit lidhet me ngarkesën e gjykatave për shkak të reformimit të sistemit të drejtësisë, që është një faktor që duhet marrë në konsideratë nga Gjykata, ashtu siç është vlerësuar edhe nga Gjykata e Lartë.

50. Për sa i takon këtij argumenti, Gjykata e Lartë, në vendimin për rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave të kërkuessit, ka vlerësuar se ndonëse *“çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së (1 vit), pasi nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit dhe deri në paraqitjen e kësaj kërkesë ka kaluar një kohë prej rreth 4 vitesh”*, mosveprimi i gjykatës *“nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit”*. Në arsyetimin e vendimit, Gjykata e Lartë ka interpretuar konceptin *“pamundësi objektive”* të nenit 399/2 të KPC-së, duke përfshirë në të gjendjen e sistemit të drejtësisë për shkak të reformimit të tij, që ka shkaktuar uljen e numrit të gjyqtarëve dhe rritjen e ngarkesës së punës në gjykata, si dhe ka konkluduar se vonesat për shkak të reformës, nuk duhet të llogariten në kohëzgjatjen e gjykimit (*shih paragrafët 20, 26 dhe 27 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

51. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjen konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Megjithatë, Gjykata ndërhyr në ato raste, kur, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Për sa më lart, ndonëse sipas nenit 141 të Kushtetutës, Gjykata e Lartë ka në kompetencën e saj interpretimin e ligjit, Gjykata çmon se duhet analizuar nëse interpretimi që ajo i ka bërë nenit 399/2 të KPC-së dhe zbatimi i tij në çështjen konkrete ka mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se ligjvënësi, në miratimin e neneve 399/1 e vijues të KPC-së, ka synuar krijimin e një mjeti juridik efektiv për t'i

garantuar individit të drejtën kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, duke i dhënë një rol specifik gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe në veçanti Gjykatës së Lartë, që përmes shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim të parandalojnë shkeljet kushtetuese në zbatim të parimit të subsidiaritetit, pasi siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Në vijim, Gjykata evidenton se argumenti kryesor që qëndron në thelb të interpretimit ligjor të Gjykatës së Lartë për *“pamundësinë objektive”*, lidhet me ngarkesën e gjykatave, i cili nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjykimit. Pa mohuar nevojën, rëndësinë dhe përfitimet që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, Gjykata rithekson se ligjvënësi ka detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të këtij lloji. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga vetë gjykatat për të nxitur përkohësisht përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe masa të tilla nuk rezultojnë efektive dhe tejzgjatja e procedurave kthehet në problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të ndërhyjë me miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Duke analizuar gjendjen e Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata vëren se ankimi i kërkuessit është regjistruar në datën 9.9.2016, kur reforma ishte drejt finalizimit. Ndërkohë, në datën 28.12.2021, teksa reforma është ende në proces zbatimi dhe çështja e kërkuessit vijon pa vendimmarrje, numri i gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit është ulur në 5 dhe ngarkesa e çështjeve është 2683–4378 çështje për çdo gjyqtar, ku volumni i çështjeve të gjyqtarës



relatore B.H. rezulton të jetë më i larti. Çështjet gjyqësore janë vënë në lëvizje sipas radhës kohore dhe po shqyrtohen ato të regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017, ndërkohë që çështja e kërkesit është regjistruar në shtator 2016.

55. Ngarkesa e lartë e punës pranohet edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), i cili është organi kushtetues që, sipas nenit 147, pika 1, të Kushtetutës, ka përgjegjësinë për të siguruar jo vetëm pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e pushtetit gjyqësor, por edhe mbarëvajtjen e tij. Kështu, KLGJ-ja raporton se në vitin 2020 Gjykata Administrative e Apelit paraqet një nivel të ulët të efikasitetit në drejtim të rritjes së çështjeve të prapambetura dhe zgjatjes së afateve kohore, me tregues të tillë si: i) rendimenti mesatar i likuidimit të çështjeve për gjyqtar është ulur me 61% në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë; ii) norma e likuidimit të çështjeve është ulur nga 86% në vitin 2019, në 37% në vitin 2020; iii) koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje është rritur nga 1171 ditë në 4020 ditë. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se, pavarësisht masave të planifikuara nga KLGJ-ja, të shprehura edhe në planin e veprimit janar 2019 – dhjetor 2020, për reduktimin e çështjeve të mbartura në gjykatat e të gjitha niveleve, përmes hartimit të planeve të veprimit, ende mungojnë treguesit për përmirësimin e gjendjes në Gjykatën Administrative të Apelit, për rrjedhojë këto masa duket se nuk kanë dhënë efektet e duhura në rastin e çështjes së kërkesit (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Duke i analizuar treguesit e mësipërm, Gjykata çmon se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkesit është pasojë e ngarkesës së lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe e ngarkesës së lartë të punës së gjyqtarëve, e shkaktuar nga ulja e numrit të gjyqtarëve nga zbatimi i procesit të rivlerësimit kalimtar, pjesë e reformës në drejtësi. Gjykata, në bazë të standardeve të përmendura në paragrafin 53 të këtij vendimi, duke mbajtur në konsideratë faktin se kjo lloj ngarkese pune është duke zgjatur disa vite, se numri i gjyqtarëve vijon në rënie dhe se metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja nuk po i japin zgjidhje ngarkesës së punës, vlerëson se sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti të atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk ka qenë në nivelin e duhur të

efikasitetit, duke i shkaktuar kërkesit vonesë të paarsyeshme në gjykimin e çështjes së tij.

57. Gjykata thekson se gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, që efektet e zbatimit të reformës në drejtësi të jenë të përkohshme dhe që gjykatat të plotësohen me personel dhe të organizohen në kohën e duhur, sipas standardeve kushtetuese, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve. Për më tepër, mbingarkesa në gjykata është situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga kërkesi, por vetëm nga përgjegjësit e administrimit të drejtësisë, detyra e të cilëve është që të krijojnë një sistem gjyqësor efikas dhe të pajisur me personel, në mënyrë që t'u përgjigjet më së miri kriterëve të shtetit të së drejtës lidhur me ecurinë e proceseve gjyqësore. Ndërkohë që ky detyrim kushtetues prej tyre nuk rezulton të jetë respektuar (*shih vendimin nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Si përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit brenda afatit të arsyeshëm dhe vlerësimi i kryer nga Gjykata e Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën për përshpejtimin e procedurave, duhet të shfuqizohet dhe gjykimi i ankimit të kërkesit nga Gjykata Administrative e Apelit duhet të përshpejtohet. Për këtë qëllim të fundit, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon të caktojë afatin 6-mujor, brenda të cilit Gjykata Administrative e Apelit duhet të veprojë. Në vlerësimin e Gjykatës, ky afat konsiderohet i arsyeshëm në raport me të drejtën kushtetuese të kërkesit, por, gjithashtu, u përgjigjet kushteve dhe mundësive aktuale të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila është duke shqyrtuar çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e



Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
3. Shfuqizimin e vendimit nr. 25/22, datë 17.6.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.2.2022

Shpallur më 18.3.2022

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë pro: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo, Altin Binaj, Sonila Bejtja

Anëtarë kundër: Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur në këtë çështje në lidhje me pretendimin e kërkuarit për cenimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Shumica ka arsyetuar se në rastin e kërkuarit ka pasur shkelje të procesit të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes së tij brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit. Sipas saj, në çështjen në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të procedurave gjyqësore, e cila: *së pari*, nuk i atribuohet kërkuarit, që ka vepruar në përputhje me të drejtat e detyrimit procedurale dhe nuk rezultojnë të jetë bërë pengesë për vonesa; *së dyti*, nuk vjen nga kompleksiteti i çështjes, që për nga natyra e saj nuk mund të bëhet shkak për tejzgjatjen e afatit. Në përfundim, shumica ka vlerësuar të bazuar dhe ka pranuar pretendimet e kërkuarit për sa i përket sjelljes së autoriteteve, duke arsyetuar se veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë shkaktuar

tejzgjatjen e afatit të arsyeshëm në rastin e tij (*shih paragrafët 56-58 të vendimit*).

3. Për sa i përket kësaj çështjeje, në parim, kam qëndrim ndryshe lidhur me kriteret e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, si janë analizuar ato e, për rrjedhojë, si janë zbatuar në rastin konkret, të cilat do t'i parashtroj në vijim.

A. Për standardet e Gjykatës Kushtetuese dhe respektimin e jurisprudencës së saj

4. Në jurisprudencën e saj, rishtazi, pas hyrjes në fuqi të dispozitave për kohëzgjatjen e arsyeshme të proceseve gjyqësore në nenin 399 e vijim të KPC-së, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm gjykimin (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Konkretisht, në këto vendime, krahas kriterit vlerësues të sjelljes së kërkuarit, Gjykata ka afirmuar si kriter veçanërisht të rëndësishëm, interesin e lartë të kërkuarit dhe rrezikun që passjell tejzgjatja e procedurave për të. Në këto çështje, sjellja e kërkuarit u analizua bashkë me interesin e tij dhe atë çfarë rrezikonte nga tejzgjatja (*shih paragrafin 60 “Sjellja/interesi për kërkuarën dhe rrezikun që passjell tejzgjatja e procedurave për të” të vendimit nr. 33, datë 1.11.2021, si dhe paragrafin 49 të vendimit nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Një nga çështjet e trajtuara nga Gjykata në këto vendimmarrje kishte si kërkuar një pensionist, ndërsa çështja kishte të bënte me pension pleqërie (*shih paragrafin 51 të vendimit nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata e vlerësoi çështjen me kujdes të posaçëm dhe rigorozitet, duke pranuar pretendimet e parashtruara nga kërkuari, si dhe detyroi Gjykatën e Lartë që brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të saj të gjykonte çështjen e tij.

6. Vendimet e cituara përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe vendosin standarde edhe për veprimtarinë e gjyqësorit të zakonshëm. Kjo “doktrinë kushtetuese zyrtare” në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të proceseve, u pa nën dritën e standardeve të vendimmarrjes së fundit të GJEDNJ-së në këtë drejtim në çështjen *Bara dhe Kola k. Shqipërisë*, vendim i datës 12.10.2021 (*shih vendimin nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), përmes të cilit GJEDNJ-ja ritheksoi se vlerësimi i arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes



dhe në referim të kriterëve të tilla si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit dhe e autoriteteve respektive, si dhe interesi i kërkuarit në mosmarrëveshjen konkrete. (*shih vendimin e GJEDNJ-së Bara dhe Kola k. Shqipërisë, datë 12.10.2021, §§ 63*). Ndaj edhe kriteret u riinterpretuan në mënyrë të tillë nga kjo Gjykatë, që edhe pse situata e reformës në drejtësi ka sjellë efekte të ngarkesës dhe akumulimit të çështjeve tej parashikimit, të ruhet sistemi i vlerave të sanksionuara në Kushtetutë përmes forcimit të garancive mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, si dhe të garancive të të drejtave dhe lirive të individit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar përgjithësisht.

7. Kriteri “interesi i kërkuarit dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të”, përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, çka është pranuar edhe nga kjo Gjykatë që përpara ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, kur ajo kontrollonte standardet e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe vetëm konstatonte shkeljen përmes vendimeve deklarative në këtë aspekt të procesit (*shih vendimet nr. 14, datë 10.3.2016, paragrafët 10 dhe 14; nr. 76, datë 4.12.2017, paragrafi 19, të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, edhe në vendime të fazës tranzitore, ku kjo Gjykatë vazhdonte vetëm të konstatonte shkeljen, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ajo ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuarit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimin nr. 16, datë 16.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 24*).

8. Edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së rezulton se vlerësimi nëse në një çështje të caktuar ka pasur shkelje të afatit të arsyeshëm karakterizohet nga realizmi. Afati i arsyeshëm i parashikuar në nenin 6/1 të KEDNJ-së duhet vlerësuar në çdo rast në varësi të rrethanave të çështjes. Vlerësimi i këtij afati duhet bërë duke pasur parasysh kritere të tilla, si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit dhe e autoriteteve përkatëse, si dhe çfarë rrezikon kërkuari (*shih vendimin e GJEDNJ-së Frydlander k. Francës [GC], datë 27.6.2000, §43*). Për sa i përket shpejtësisë që duhet treguar nga autoritetet, GJEDNJ-ja ka bërë dallim

mes çështjeve që kërkojnë “kujdes të veçantë” dhe atyre ndaj të cilave kërkohet “kujdes veçanërisht i posaçëm” (*shih vendimin e GJEDNJ-së Süßmann k. Gjermanisë, datë 16.9.1996, §61*). Vendosja e një balance të drejtë mes aspekteve të ndryshme të detyrimit themelor të parashikuar në nenin 6/1 “procedura gjyqësore të shpejta” përbën vetëm një element të “parimit të përgjithshëm të administrimit të drejtësisë” (*shih vendimin e GJEDNJ-së Boddaert k. Belgjikës, datë 12.10.1992, §39*).

9. Në vështrim të sa më lart, vlerësoj se kriteri përcaktues dhe i domosdoshëm, që duhet të merret në konsideratë nga Gjykata në këto çështje, është “interesi i lartë i kërkuarit, si dhe rreziku që passjell tejzgjatja e procedurave për të”, pasi vetëm ky kriter mund të bëjë dallimin në situatën konkrete të ngarkesës mes nevojës për të shqyrtuar të gjitha çështjet sipas afateve të arsyeshme, në zbatim të neneve 399 e vijues të KPC-së, dhe mundësisë e kapaciteteve aktuale të gjyqësorit për të respektuar këtë standard.

10. Në analizë të rastit konkret, shumica krahas kriterit “sjellja e kërkuarit” nuk ka vendosur si kriter edhe “interesin e kërkuarit dhe pasojat e tejzgjatjes”, për rrjedhojë, në mendimin tim, duke mos i vënë theksin as në strukturën formale të vendimit (*shih paragrafin 39 të vendimit “Sjellja e kërkuarit”*), nuk e ka analizuar atë me vëmendje të posaçme, duke mos respektuar kështu standardet e mëparshme të vendosura nga Gjykata në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit, çka krijon paqartësi për zbatimin e kriterëve që duhet të aplikohen për çështje të kësaj natyre edhe në të ardhmen.

B. Për juridiksionin kushtetues dhe juridiksionin e gjyqësorit të zakonshëm në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit

11. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që



gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Legjislacioni procedural në fuqi parashikon të drejtën e palëve për të kërkuar, në raste të caktuara, përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tyre nga gjykatat më shpejt se sa afatet e përcaktuara nga nenet 399 e vijues të KPC-së. Neni 460, pika 3 e KPC-së parashikon të drejtën e palëve që, për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, të kërkojnë përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes nga gjykata e apelit. Neni 1, pika 2, i ligjit nr. 49/2012 parashikon se dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e KPC-së, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe. Për rrjedhojë, kjo dispozitë ligjore, pra neni 460, pika 3 i KPC-së, zbatohet edhe ndaj çështjeve me karakter administrativ.

13. Po kështu, bazuar në nenin 460, pika 4, të KPC-së, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka nxjerrë vendimin nr. 78, datë 30.5.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” (*vendimi nr. 78/2019*), që ka përcaktuar disa kategori çështjesh, shqyrtimi i të cilave, për shkak të natyrës dhe kategorisë, duhet përshpejtuar nga gjykatat. Sipas këtij vendimi, për sa i përket natyrës, çështjet që kërkojnë përshpejtim janë: a) çështjet që kanë për objekt të drejta të fëmijës ose që kanë ndikim te një fëmijë i mitur; b) çështjet që kanë për objekt zgjidhjen ose pavlefshmërinë e martesës; c) çështjet që kanë për objekt detyrim për ushqim; ç) çështjet që kanë për objekt kujdestarinë; d) çështjet që kanë për objekt heqjen, kufizimin ose kthimin e zotësisë për të vepruar dhe ato që kanë për objekt të drejta të personave që iu është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar; dh) çështjet që kanë për objekt birësimin; e) çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë është shprehur me vendim jopërfundimtar, ndaj të cilit është ushtruar e drejta e ankimit të veçantë, të tilla si: çështjet me objekt ndreqjen e gabimit, sqarimin ose interpretimin e vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin e ankimit në gjykatën e

apelit kundër vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; çështjet me objekt rivendosjen në afat të ankimit në gjykatën e apelit; çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur kthimin e akteve ose pushimin e gjykimit; ë) çështjet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka vendosur refuzimin e dhënies/lëshimit të urdhrit të ekzekutimit; f) çështjet që kanë për objekt plotësim të vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë; g) çështjet që kanë për objekt vërtetimin e faktit juridik të vjetërsisë në punë ose njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së dokumentit me pasoja juridike sa i përket përfitimit të pensionit; gj) çështjet që kanë për objekt shpërblimin e dëmit nga zgjidhja e kontratës së punës; h) çështjet në të cilat pala që ka paraqitur ankim heq dorë nga ankimi ose ato në të cilat paditësi heq dorë nga e drejta e padisë, i) çështjet me interes ose ndjeshmëri veçanërisht të lartë për opinionin publik ose ato që prekin interesa të komuniteteve të caktuara, në veçanti ato në nevojë.

14. Përveç sa më lart, vendimi i KLGJ-së parashikon se për çdo lloj çështjeje, pavarësisht natyrës dhe kategorisë së saj, palët mund të kërkojnë përshpejtimin e shqyrtimit të saj për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin. Këto shkaqe vlerësohen nga gjyqtari relator sipas bindjes së tij të brendshme, bazuar në rrethanat e parashtruara nga pala. Me “shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara” nënkuptohen ato shkaqe personale të palës, të lidhura me shqyrtimin e çështjes dhe objektin e saj apo ato shkaqe që përcaktojnë ose kushtëzojnë ecurinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes kryesore të palëve ndërgjyqëse, ekzistenca e të cilave motivon shqyrtimin e përshpejtuar të çështjes, domethënë shqyrtimin e saj në një afat më të shkurtër nga afati ligjor ose nga afati i arsyeshëm sipas nenit 399/2 të KPC-së dhe/ose sipas këtij neni në lidhje me nenin 109, pika 4, të ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017. “Shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara” mund të jenë, pa u kufizuar: a) pamundësia objektive e palës për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në një të ardhme të caktuar, ndërsa ajo ka zgjedhur që mbrojtjen e interesave të saj në gjykim ta realizojë personalisht ose kur prania e saj në gjykim konsiderohet e qenësishme për efekt të procesit të të provuarit; b) gjendja shëndetësore e palës ose mosha e saj është e tillë që mund të vërë në dyshim



pritsmërinë e saj për një vendim gjyqësor që lidhet me një të drejtë personale; c) çështja ka përbërë shkak pezullimi për një çështje tjetër gjyqësore; ç) çështjet, shqyrtimi i të cilave në gjykatën e shkallës së parë ka zgatur përmbi 2 vjet; d) çështjet të cilat ligji i ka përcaktuar në juridiksionin fillestar gjyqësor të gjykatës së apelit dhe shqyrtimi i të cilave në juridiksionin administrativ ka zgatur përmbi 2 vjet (shih pikat 4, 5 dhe 6, kreu II, të vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së).

15. Në vijim, kur pala bën kërkesë për përshpejtim, gjyqtari relator shqyrton kërkesën e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, jo më vonë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës. Kur kërkesa e palës për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes vlerësohet e bazuar, gjyqtari relator vendos pranimin e saj, duke parashtruar edhe arsyet në lidhje me vlerësimin e tij, në këtë rast, në varësi të ngarkesës dhe të urgjencës së çështjes, edhe intervalin kohor brenda të cilit çështja do të planifikohet në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve. Sekretari gjyqësor i gjyqtarit relator kujdeset për ndjekjen e planifikimit të çështjes në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve sipas planifikimit paraprak në aktin përkatës të gjyqtarit relator (shih pikat 7 dhe 8, kreu III, të vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së).

16. Për sa më lart, parimi i shpejtësisë së gjykimit dhe i prioritizimit, jo duke u nisur vetëm nga periudha kohore e paraqitjes së kërkesës, padisë, ankimit ose rekursit, mund të zbatohet për një numër të caktuar çështjesh dhe kalendarin e tyre është caktuar nga KLGJ-ja, duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare dhe kombëtare, por edhe situatën aktuale të mbingarkesës.

17. Në vështrim të sa më lart, duke mos iu përmbajtur kriterëve kushtetuese të vëna prej saj, me jurisprudencën ndër vite dhe që prezumohet se ka gjetur pasqyrim edhe në kuadrin ligjor e nënligjor, shumica ka ndërhyrë në kompetencat e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në rastin konkret në kalendarin e shqyrtimit të çështjeve nga relatorja, duke ndryshuar kështu kriteret për prioritizimin e çështjeve për shqyrtim para këtyre gjykatave, i cili merr parasysh edhe gjendjen aktuale të ngarkesës së gjyqësorit.

C. Për zbatimin e standardeve në çështjen konkrete

18. Në çështjen konkrete do të analizoj vetëm ato kritere të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, ku ndahem me shumicën, për sa më poshtë:

C.1 Sjellja dhe interesi i kërkuarit/ çfarë ai rrezikon dhe pasojat që mund t'i vijnë nga tejzgjatja

19. Rezulton se çështja për të cilën kërkuar ka kërkuar përshpejtimin e gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit është administrative (konstatim i pavlefshmërisë absolute të akteve administrative), ndërsa pretendimet e tij, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë, të fituara me vendimin nr. 132/1996 të KKPP-së, që i përket një gjykimi civil.

20. Gjykata ka theksuar se për çështjet e lidhura me pensionin, kujdestarinë ose raste të tjera të ngjashme, duhet të tregohet një kujdes më i madh (*shih vendimin nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për rrjedhojë, në drejtum të rrezikut që passjell për kërkuar të tejzgjatja e procedurave, vlerësoj se, në thelb, kjo çështje nuk rezulton të jetë e tillë që për shkak të natyrës së saj të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit, pasi ajo çfarë kërkuar rrezikon në këtë konflikt gjyqësor nuk përfshihet në të drejta dhe interesa të natyrës veçanërisht serioze. Duke konsideruar dhe analizuar më në thellësi se çfarë pasoje ose rreziku sjell për kërkuar të tejzgjatja e procesit, çmoj se shumica duhet të kishte dalë në konkluzion të ndryshëm për çështjen.

22. Çështjet me bazë konflikte pronësie për kategorinë e ish-pronarëve kanë rëndësi, pasi e drejta e pronës është shqetësim serioz për këtë kategori subjektësh, por edhe fakti i të qenit objekt gjykimi një konflikt prone, nuk do t'i jepte prioritet kësaj kategorie nga gjykatat aktualisht, pasi referuar situatës post reformë, e cila orienton dhe presupozohet që ka gjetur një balancë mes përcaktimit të çështjeve prioritare dhe situatës së rënduar me mbingarkesë çështjesh gjyqësore, tashmë janë përcaktuar çështjet të cilat do të jenë prioritare (*shih paragrafët 13-14 të kësaj pakeje*).

23. Për më tepër, vlerësoj se për sa i përket sjelljes së kërkuarit, ai mund të kishte marrë edhe masa të tjera për garantimin e së drejtës së tij të pronësisë, në kushtet kur në vendimin nr. 447, datë 31.3.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka arsyetuar, ndër të tjera, se duke qenë se pretendimet e tij, në thelb, i përkisnin një gjykimi civil dhe jo atij administrativ, kërkuar duhet të godiste për pavlefshmëri titullin e pronësisë së personit të tretë dhe më pas të kërkonte çregjistrimin e pronës nga pala e paditur ZVRPP-ja,



Fier dhe regjistrimin e saj, nëse plotësonte kriteret ligjore, në emrin e tij (*shih fagen 5 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë*).

C.2 Sjellja e autoriteteve

24. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, shumica ka pranuar ekzistencën e një volumi të lartë të çështjeve për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe numrin e reduktuar të gjyqtarëve aktualë në këtë gjykatë, megjithatë ka vlerësuar se në rastin e kërkuarit ka pasur shkelje të standardit të gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi kjo çështje është regjistruar në shtator të vitit 2016 dhe sipas radhës kohore duhet të ishte shqyrtuar (*shih paragrafin 54 të vendimit*).

25. Ndër vite nga kjo Gjykatë është analizuar se sjellja e autoriteteve nuk i atribuohet vetëm gjyqtarit, por të gjithë sistemit dhe aktorëve institucionalë, të cilët kanë detyrimet përkatëse për marrjen e masave të nevojshme. Edhe së fundmi, sipas Gjykatës, në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, ajo vlerëson të tregojë një qasje më të kujdesshme, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Në këtë situatë, Gjykata, ashtu sikundër GJEDNJ-ja, merr në konsideratë dhe njeh faktin se një vend i vogël si ky yni ka vështirësi në plotësimin me burime njerëzore të nevojshme dhe të mjaftueshme të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Po në këtë drejtim, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji (*shih Buchholz kundër Gjermanisë, 6 maj 1981, §51*). Metodat që mund të nxisin përkohësisht përshpejtimin janë ato kur për gjykimin e çështjeve ndiqet një radhë e caktuar e bazuar jo vetëm në datën e depozitimit të tyre, por edhe në nivelin e urgjencës dhe rëndësisë së tyre, dhe, në veçanti, të vlerësimit të asaj që përbën rrezik për personat në fjalë. Megjithatë, nëse një zgjidhje e këtij lloji rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë këto metoda nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë

miratimin e masave më efektive (*shih Guincho kundër Portugalisë, 10 korrik 1984, § 40; Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës, 13 korrik 1983, § 29*).

27. Në vështrim të sa më lart, duke iu referuar rastit konkret, ndryshe nga shumica, e cila te ky kriter, ka analizuar detyrimet e autoriteteve përtej gjyqësorit (*shih paragrafin 56 të vendimit*), vlerësoj të ndalem te rrethanat specifike të kësaj çështjeje, në drejtim të veprimeve të relatores, si dhe ngarkesës së saj, si një element thelbësor në tërësinë e kriterit “sjellja e autoriteteve”.

28. Duke iu referuar informacionit të ardhur për çështjen nga Gjykata Administrative e Apelit, rezulton se relatorja aktuale për çështjen e kërkuarit është caktuar, përmes shortit, në datën 16.12.2021. Po sipas këtij informacioni, kjo gjyqtare ka aktualisht një ngarkesë prej 4378 çështjesh dhe çështja e kërkuarit i ka kaluar për shqyrtim veç në dhjetor 2021.

29. Bazuar në këto të dhëna të natyrës faktike, vlerësoj se vonesat në shqyrtimin e çështjes, haptazi nuk mund t'i atribuohen relatores. Për më tepër, e gjithë kjo ngarkesë jo vetëm nuk duhet t'u atribuohet gjyqtarëve, por kërkon marrjen e masave konkrete afatgjata nga institucionet përgjegjëse, përtej atyre që janë marrë deri tani, ose dhe atyre që kanë të bëjnë me përcaktimin e çështjeve prioritare për shqyrtim nga gjykatat, bazuar në natyrën dhe karakterin e veçantë të çështjes, masa të cilat dhe kjo Gjykatë ka theksuar që nuk janë të mjaftueshme. (*shih vendimet nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

D. Në lidhje me dispozitivin e vendimit

30. Në përfundim, në arsyetimin e saj shumica shprehet se: “Gjykata thekson, gjithashtu, domosdoshmërinë përshpejtimin të procedurës së gjyqimit të çështjes së themelit të kërkuarit dhe, për këtë qëllim, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ajo do të caktojë në pjesën urdhëruese të këtij vendimi edhe afatin brenda të cilit duhet të veprojë Gjykata Administrative e Apelit. Në vlerësimin e Gjykatës, ky afat konsiderohet i arsyeshëm dhe u përgjigjet kushteve dhe mundësive të Gjykatës Administrative të Apelit për të vepruar në çështjen e kërkuarit, e cila është duke shqyrtuar çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016–shkurt 2017 (*shih paragrafin 58 të vendimit*). Sipas dispozitivit, urdhërohet gjykata të



shqyrtojë çështjen brenda 6 muajve, nga hyrja në fuqi e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

31. Për sa më lart, duke pranuar se ka shkelje të kohëzgjatjes së arsyeshme dhe duke vendosur detyrim për Gjykatën Administrative të Apelit, që brenda 6 muajve të shqyrtojë themelin e çështjes, shumica nuk ka reflektuar qasjen e duhur as mbi efektivitetin e vendimeve të saj, të cilat rrezikojnë të mbeten të pazbatuara, dhe as në pamundësinë ose mundësinë e kësaj gjykate për të shqyrtuar këtë çështje. Në këtë drejtim, ajo nuk ka qartësuar se mbi çfarë kriteresh e konsideron afatin 6-mujor të arsyeshëm dhe që u përgjigjet kushteve e mundësive të Gjykatës Administrative të Apelit (relatores) për të vepruar në çështjen e kërkuarit. Argumenti i shumicës “sipas periudhës kohore”, i ka ardhur koha, nuk është i mjaftueshëm për të dalë në konkluzionin se, për këtë arsye, Gjykata e Apelit Administrativ ka mundësi ta shqyrtojë brenda 6-muajve.

32. Nga ana tjetër, vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së, për sa i përket kategorisë, ka parashikuar se kërkojnë, gjithashtu, përparësi në përshejtim çështjet që duhen shqyrtuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (*shih pikën 3.2, kreu II, të vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së*), një arsye më tepër për të pasur kujdes në vënien e afateve, që mund të krijojnë përplasje me kalendarin e çështjeve, ku mund të ketë çështje më prioritare (*shih paragrafët 13–14 të kësaj pakice*).

E. Konkluzione

33. Në vështrim të të gjitha sa më sipër, mendoj se qëndrimi i shumicës është një vlerësim i nxituar dhe i shkëputur nga realiteti kompleks i organizimit dhe funksionit të gjyqësorit aktualisht, edhe pse shkresa e dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit e pasqyron më së miri këtë realitet me mbingarkesë çështjesh gjyqësore.

34. Ky qëndrim i pakicës nuk nënkupton në asnjë rast që sistemi gjyqësor nuk duhet të jetë në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, megjithatë kjo Gjykatë, krahas sigurimit të njëtrajshmërisë së jurisprudencës kushtetuese, për sa i takon vlerësimin të faktorëve që duhet të garantojnë standardet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet edhe të konstitucionalizojë gjyqësorin e zakonshëm përmes vendimeve të saj. Në rastin konkret, vlerësoj se Gjykata, duke mos përcaktuar kriteret e sakta dhe të qarta, po i orienton këto lloj procesesh gjyqësore në

subjektivizëm, duke sjellë pasoja edhe për gjyqësorin e zakonshëm, i cili, përveç kriterëve të sipërcituara (*shih paragrafët 13–14 të kësaj pakice*), do të duhet të orientohet drejt zhvillimit të proceseve gjyqësore, sipas kriterëve (në fakt, mungesës së kriterëve të qarta), të vëna prej saj.

35. Si përfundim, vlerësoj se kërkesa e kërkuarit duhet të rrëzohej, duke marrë në konsideratë kriterin e interesit/rrezikut që passjell për kërkuarin tejzgjatja e procedurave, si dhe kriterin e sjelljes së autoriteteve dhe, më konkretisht, një faktori që qëndron brenda kriterit të sjelljes së autoriteteve, specifikisht referuar mosveprimeve ose veprimeve të relatores së çështjes, të tilla që të kenë ndikuar në vonesat e çështjes.

Tiranë, më 17.2.2022

Anëtare: Elsa Toska

NJOFTIM

Nr. 4076, datë 28.3.2022

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

“Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”, nënshkruar më 18.1.2021, ka hyrë në fuqi më 18.3.2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME

Armand Skapi

KËRKESË

Nr. 181/4, datë 25.3.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti arkitektonik “Mozaiku i Tiranës”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Ministria e Kulturës.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për



pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 9 348 835 54 (nëntë milionë e treqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e katër) lekë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni**

**LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI
ARKITEKTONIK “MOZAIKU I TIRANËS”**

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)					Sipërfaqja që shpronësohet			SHËNIME (KUFIZIME HIPOTEKORE, BARRË MBI PASURINË etj.)	
									TRUALL				VLERA TOTALE (lekë)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	D	E	F	G	H	P	Q	R	Z	
1	Artur		Kurti	Tiranë	8210	6/52	Truall	164	164.0	38,614.00	6,332,696	6,332,696	Për pjesën takuese të pasurisë së znj. Rudina Mamo Struga, është vendosur sekuestro konservative nr. 2824, datë 20,04,11
	Agim		Gjuzi										
	Ardiana	Et'hem	Gjuzi										
	Azem		Sedja										
	Beqir		Sedja										
	Ervis		Sinella										
	Fatbardh		Allajbeu										
	Fatime		Bishqemi										
	Fitnete		Sedja										
	Hamdi		Allajbeu										
	Hava		Kullolli										
	Hazbije		Sedja										
	Hyqmet		Shyti										
	Ilir		Gjuzi										
	Isuf		Gjuzi										
	Kadri		Allajbeu										
	Lirije		Allajbeu										
	Mirela		Isufi										
	Muhamed		Allajbeu										
	Muharrem	Halit	Sedja										
	Naxhije		Sinella										
	Nysrete		Bishqemi										
	Petrit		Shyti										
	Rabihane		Muka										
	Ramazan		Sedja										
	Resmije		Hashini										
	Rovena		Sinella										
	Ruzhdi		Sedja										
	Sabije		Hoxha										
	Servete		Kanapari										
	Sulejman	Ismail	Sedja										
	Vjollca		Harizi										
Xhavit		Allajbeu											
Xhevdet		Allajbeu											
Asim		Kurti											
Astrit		Kurti											
Bujar		Mara											



	Dylaver		Sedja										
	Edlira		Malile (Balih)										
	Edvin		Mara										
	Emona		Mara										
	Engjëllushe		Kurti										
	Ermon		Kurti										
	Hidajete		Sinella										
	Lirie	Haki	Gumeni										
	Mukades		Sinella (Karkini)										
	Neim		Kurti										
	Sabiha		Kurti										
	Sezar		Malile										
	Teuta		Vrahoriti (Kurti)										
	Xhamide	Hajdar	Kurti										
	Agim	Abaz	Sami										
	Ali		Dollia										
	Ballkiz		Struga										
	Hasan		Sami										
	Mehmet	Abdulla	Struga										
	Mimoza		Kurti										
	Nadire		Konci										
	Rudina		Mamo (Struga)										
2	Artur		Kurti	Tiranë	8210	6/44	Truall	78.11	78.11	38614	3,016,139.54	3,016,139.54	Për pjesën takuese të pasurisë së znj. Rudina Mamo Struga, është vendosur sekuestro konservative nr. 2824, datë 20.4.11
	Agim		Gjuzi										
	Ardiana	Et'hem	Gjuzi										
	Azem		Sedja										
	Beqir		Sedja										
	Ervis		Sinella										
	Fatbardh		Allajbeu										
	Fatime		Bishqemi										
	Fitnete		Sedja										
	Hamdi		Allajbeu										
	Hava		Kullolli										
	Hazbije		Sedja										
	Hyqmet		Shyti										
	Ilir		Gjuzi										
	Isuf		Gjuzi										
	Kadri		Allajbeu										
	Lirije		Allajbeu										
	Mirela		Isufi										
	Muhamed		Allajbeu										
	Muharrem	Halit	Sedja										
	Naxhije		Sinella										
	Nysrete		Bishqemi										
	Petrit		Shyti										
	Rabihane		Muka										
	Ramazan		Sedja										
	Resmije		Hashini										
	Rovena		Sinella										
	Ruzhdi		Sedja										
	Sabije		Hoxha										
	Servete		Kanapari										
	Sulejman	Ismail	Sedja										
	Vjollca		Harizi										
	Xhavit		Allajbeu										
	Xhevdet		Allajbeu										
	Asim		Kurti										
	Astrit		Kurti										
	Bujar		Mara										
	Dylaver		Sedja										
	Edlira		Malile (Balih)										
	Edvin		Mara										
	Emona		Mara										
	Engjëllushe		Kurti										
	Ermon		Kurti										
	Hidajete		Sinella										
	Lirie	Haki	Gumeni										
	Mukades		Sinella (Karkini)										
	Neim		Kurti										
	Sabiha		Kurti										
	Sezar		Malile										



	Teuta		Vrahoriti (Kurti)										
	Xhamide	Hajdar	Kurti										
	Agim	Abaz	Sami										
	Ali		Dollia										
	Ballkiz		Struga										
	Hasan		Sami										
	Mehmet	Abdulla	Struga										
	Mimoza		Kurti										
	Nadire		Konci										
	Rudina		Mamo (Struga)										
3	Shtet			Tiranë	8210	6/53				0		Plotësim dokumentacioni. Pritet konfirmimi nga ASHK-ja	
4	Shtet			Tiranë	8210	6/55		585.98	585.98	0			
5	Shtet			Tiranë	8210	6/381		104.32	104.32	0			
Mbyllet me numër rendor 5										SHUMA TOTALE		9,348,835.54	
SHËNIM.													
1. ÇMIMET JANË MARRË NGA HARTA E VLERËS, MIRATUAR ME VKM NR. 89, DATË 3.2.2016													

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006